

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR EKSPLOATIMIN E GURIT GËLQËROR, NGA
KOMPANIA “STONEX HOLDING” SH.P.K., BLLACË,
KOMUNA E SUHAREKËS**



INVESTITORI
“StoneX Holding” SH.P.K.
Bllacë, Suharekë

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS PËR EKSPLOATIMIN E GURIT GËLQËROR, NGA KOMPANIA “STONEX HOLDING” SH.P.K., BLLACË, KOMUNA E SUHAREKËS

Ngastrat me nr. P-72116003 - 04427-0, P-72116003 - 04428-0, P-72116003 - 04429-0, P-72116003 - 04430-0, P-72116003 - 04431-0, P-72116003 - 04441-0, P-72116003 - 04442-0, Zona kadastrale Bllacë, Komuna e Suharekës

INVESTITORI	
Aplikuesi	Genc Bajraktari
Iinvestitori	“StoneX Holding” SH.P.K.
Adresa:	Brigada 123, pn
Lokacioni i Fabrikës	Bllacë, Komuna e Suharekës
Tel:	+383 49 460 512 +383 49 761 765
Email:	info@stonexholding.eu

Investitori:

“StoneX Holding” SH.P.K.

Emri i Hartuesit të Raportit të VNM-së

Bsc. Hidro. Blerina Bajraktari

Nënshkrimi

Nënshkrimi

Blerinabajraktari1@gmail.com
+383 49 588 634

PËRMBAJTJA:

1.	HYRJE.....	1
2.	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR.....	2
2.1.	Kategoria e Projektit të Propozuar.....	2
2.2.	Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit.....	2
2.3.	Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit.....	3
2.4.	Përshkrimi detaj i procesit të planifikimit të prodhimit, duke filluar nga hyrja e lëndëve të para deri te produkti përfundimtar.....	4
2.5.	Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme	4
2.6.	Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik.....	5
2.7.	Prezantimi i teknologjisë së trajtimi, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave.....	5
2.8.	Programi për ndërtimin, kohëzgjatja e ndërtimit, kohëzgjatja e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit	6
2.9.	Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme	7
2.10.	Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave.....	7
2.11.	Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin.....	7
2.12.	Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese	8
3.	PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR.....	8
3.1.	Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti.....	8
3.2.	Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit	9
3.3.	Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti.....	10
3.4.	Paraqitje e karakteristikave pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit.....	11
3.5.	Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë.....	12
3.6.	Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik.....	12
3.7.	Prezantimi i karakteristikave natyrore.....	13
3.8.	Rishikimi i karakteristikave themelore të peizazhit.....	13
3.9.	Rishikimi i objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike	14
3.10.	Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar	14
3.11.	Të dhëna për objektet ekzistuese.....	15
3.12.	Në varësi të karakteristikave të zonës, përshkrimi i lokacionit përmban edhe të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme.....	15
3.13.	Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afësi të saj	15
4.	GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR.....	16
4.1.	Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor.....	16
5.	PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT	17
5.1.	Përshkrimi i alternativave të realizueshme.....	17
5.2.	Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban edhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një alternative të caktuar duke ju referuar:	17

5.3.	Vendndodhja ose rruga.....	18
5.4.	Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut	18
5.5.	Proceset dhe teknologjia e prodhimit.....	18
5.6.	Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit.....	19
5.7.	Plani i lokacionit.....	19
5.8.	Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit.....	20
5.9.	Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit 20	
5.10.	Madhësia e lokacionit ose objektit	20
5.11.	Vëllimi i prodhimit.....	20
5.12.	Kontrolli i ndotjes.....	20
5.13.	Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar	21
5.14.	Rregulimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit	21
5.15.	Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit.....	21
5.16.	Trajnimi.....	21
5.17.	Monitorimi.....	21
5.18.	Planet për situata emergjente	22
5.19.	Demolimi dhe rehabilitimi.....	22
5.20.	Plani për menaxhimin e mjedisit.....	23
5.21.	Përshkrimi i alternativës pa veprim	23
6.	PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS	24
6.1.	Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshinë.....	24
6.2.	Cilësinë e ajrit	24
6.3.	Niveli dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi:.....	24
6.4.	Ndikimin e projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike:.....	25
6.5.	Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit:.....	25
6.6.	Cilësia e ujit.....	25
6.7.	Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore	26
6.8.	Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave	26
6.9.	Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza.....	26
6.10.	Toka	27
6.11.	Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës, etj. ...	27
6.12.	Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit të planifikuar dhe në tokën përreth dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës	27
6.13.	Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore	28
6.14.	Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur	28
6.15.	Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike	28
6.16.	Popullsia lokale	28
6.17.	Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me mjedisin, popullsinë, përqendrimi dhe migrimi.....	29
6.18.	Ndikimet vizuale të vendbanimeve	29

6.19.	Ndikimet e emetimit të ndotësve, zhurmës, vibrimet, nxehtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit në shëndetin e njeriut.....	29
6.20.	Ndikimet socio-ekonomike.....	29
6.21.	Ndikimi i projektit në strukturën e ekonomisë lokale, sipas sektorit prodhues dhe degës kryesore të zonës.....	29
6.22.	Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme të vendeve të punës në sektorët apo zonat e prekura	30
6.23.	Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare	30
6.24.	Ekosistemet dhe gjeologjia.....	30
6.25.	Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre.....	30
6.26.	Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike, biodiversitetit, florës dhe faunës, pasurive natyrore të mbrojtura, specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve të egra dhe habitateve të tyre.....	31
6.27.	Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve.....	31
6.28.	Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara	31
6.29.	Shfrytëzimi i tokës.....	31
6.30.	Infrastruktura komunale	31
6.31.	Trafiku.....	32
6.32.	Furnizimi me ujë	32
6.33.	Energjia	32
6.34.	Ujërat e zeza	32
6.35.	Gjenerimi i mbeturinave.....	32
6.36.	Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit	32
6.37.	Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacione që rezultojnë 33	
6.38.	Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit	33
6.39.	Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese	33
6.40.	Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis	33
6.41.	Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit.....	34
6.42.	Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit	34
6.43.	Emetimet në ajër të gazeve serrë gjatë operimit	34
6.44.	Ndikimet në ndryshimet klimatike	34
7.	PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS.....	35
7.1.	Masat e parashikuara me legjislacion	35
7.2.	Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha	35
7.3.	Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit.....	36
7.4.	Masat të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis.....	36
8.	PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS	38
8.1.	Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis.....	38
8.2.	Prezantimin e gjendjes mjedisore përpara se projekti të vihet në punë ose fillimi i aktiviteteve në vendet ku ndikimi mjedisor pritet.....	38
8.3.	Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis	38
8.4.	Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar.....	38
8.5.	Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera.....	39
8.6.	Detyrimin për infomuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera.....	39

8.7.	Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis.....	39
9.	PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR.....	40
9.1.	Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit.....	40
9.2.	Pajtushmeria me pëlqim mjedisor.....	40
9.3.	Inkurajimi I zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000	41
10.	INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT.....	42
10.1.	Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së,.....	42
10.1.	Baza ligjore dhe rregullative.....	42
10.2.	Dokumentacioni teknik i projektit.....	43
10.3.	Të dhënat mjedisore dhe shkencore.....	43
11.	BURIMET E TË DHËNAVE DHE LITERATURA.....	44
11.1.	Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së.....	44
12.	SHTOJCA.....	44
13.	PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT.....	45
13.1.	Hyrje.....	45
13.2.	Përshkrimi i projektit.....	45
13.3.	Ndikimet kryesore mjedisore dhe masat mbrojtëse.....	45
13.4.	Përfitimet socio-ekonomike.....	46
13.5.	Përfundim.....	46

Lista e Figurave

Figura 1.	Shtrirja hapësinore e Lokacionit të projektit në territorin e Komunës së Suharekës	9
Figura 2.	Distanca e kompanisë me qytetin e Suharekës	10
Figura 3.	Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Banimi	10

1. HYRJE

Ky Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është përgatitur për projektin e eksploatimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës. Qëllimi i këtij raporti është të identifikojë dhe të vlerësojë ndikimet e mundshme në mjedis që mund të paraqiten gjatë zhvillimit të aktivitetit minerar, si dhe të propozojë masa konkrete për parandalimin, zvogëlimin dhe menaxhimin e këtyre ndikimeve. Projekti i propozuar përfshin eksploatimin sipërfaqësor të gurit gëlqeror, i cili do të realizohet përmes punimeve përgatitore, minimin të kontrolluar në zonën e shfrytëzimit, nxjerrjes së materialit, ngarkimit dhe transportimit të tij drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Aktiviteti ka për qëllim sigurimin e materialit gëlqeror për nevojat e tregut dhe zhvillimin e veprimtarisë minerare në përputhje me kushtet teknike, standardet mjedisore dhe kërkesat ligjore në fuqi në Republikën e Kosovës. Raporti është hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe aktet nënligjore përkatëse që rregullojnë procedurën e VNM-së. Në kuadër të raportit janë trajtuar komponentët kryesorë mjedisorë, përfshirë tokën, ajrin, ujin, biodiversitetin, peizazhin, zhurmën, vibrimet, menaxhimin e mbeturinave, sigurinë gjatë punës, trafikun dhe aspektet socio-ekonomike. Ky dokument do të shërbejë si bazë për vlerësimin e projektit nga autoritetet kompetente lidhur me pajisjen me pëlqim mjedisor, si dhe për përcaktimin e kushteve dhe masave që duhet të zbatohen gjatë fazës së eksploatimit, në mënyrë që aktiviteti të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar, të sigurt dhe të qëndrueshme për mjedisin.

2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR

2.1.Kategoria e Projektit të Propozuar

Projekti i propozuar për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, i takon kategorisë së projekteve minerare për shfrytëzim sipërfaqësor të materialeve minerale ndërtimore. Aktiviteti kryesor i projektit përfshin eksploatimin e gurit gëlqeror në zonën minerare, përmes punimeve përgatitore, minimit të kontrolluar të masës shkëmbore, nxjerrjes së materialit, ngarkimit me makineri përkatëse dhe transportimit të tij drejt impiantit të thërmimit dhe separimit të kompanisë. Në këtë fazë, në lokacionin e eksploatimit nuk parashihet proces i veçantë teknologjik i përpunimit industrial të materialit, përveç aktiviteteve që lidhen drejtpërdrejt me nxjerrjen, ngarkimin dhe transportin e gurit gëlqeror. Projekti, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, i nënshtrohet procedurës së VNM-së për shkak të natyrës minerare të aktivitetit dhe mundësisë për ndikime në komponentët mjedisorë. Ndikimet e mundshme lidhen kryesisht me ndryshimin e konfiguracionit të terrenit, dëmtimin e shtresës sipërfaqësore të tokës, gjenerimin e pluhurit gjatë minimit, ngarkimit dhe transportit, si dhe krijimin e zhurmës dhe vibrimeve nga përdorimi i makinerive dhe shpërthimet e kontrolluara. Duke marrë parasysh karakterin e aktivitetit dhe mënyrën e zhvillimit të tij, projekti konsiderohet me ndikim potencial në mjedis gjatë fazës së operimit. Megjithatë, këto ndikime janë të menaxhueshme përmes zbatimit të masave parandaluese, teknike dhe organizative të përcaktuara në këtë raport.

2.2.Përshkrimi i punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Punët përgatitore për zbatimin e projektit të eksploatimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, do të fokusohen në përgatitjen e sipërfaqes së planifikuar për shfrytëzim minerar dhe krijimin e kushteve të nevojshme teknike për zhvillimin e sigurt të aktivitetit. Meqenëse projekti ka karakter minerar dhe përfshin eksploatimin sipërfaqësor të gurit gëlqeror, punët përgatitore do të realizohen para fillimit të minimit dhe nxjerrjes së materialit. Këto punë kanë për qëllim rregullimin e terrenit, organizimin e zonës së punës dhe përcaktimin e hapësirave të sigurta për lëvizjen e makinerive, kamionëve dhe personelit. Punët përgatitore përfshijnë:

- Pastrimin e sipërfaqes nga vegjetacioni i ulët, shkurret dhe materialet e papërshtatshme;
- Heqjen dhe zhvendosjen e shtresës sipërfaqësore të tokës, në rastet kur ajo është e pranishme, me qëllim ruajtjen dhe përdorimin e saj për rehabilitim të mëvonshëm të zonës;

- Stabilizimin dhe rregullimin fillestar të terrenit për krijimin e kushteve të sigurta të punës;
- Hapjen, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme për qarkullimin e makinerive dhe kamionëve transportues;
- Përcaktimin e zonave të sigurta për zhvillimin e operacioneve të minimumit të kontrolluar;
- Vendosjen e shenjave paralajmëruese dhe kufizimin e qasjes në pjesët ku zhvillohen punimet minerare;
- Organizimin e hapësirave për lëvizjen e mjeteve të punës, ngarkimin e materialit dhe transportimin e tij drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit të kompanisë.

Punët përgatitore kanë karakter të terrenit, teknik dhe organizativ. Ato do të zhvillohen me qëllim krijimin e kushteve për procesin e minimumit, nxjerrjes, ngarkimit dhe transportit të gurit gëlqeror. Gjatë kësaj faze nuk parashihet përpunim industrial i materialit në zonën e eksploatimit, por vetëm përgatitja e terrenit dhe organizimi i punës për nxjerrjen e materialit.

2.3.Përshkrimi i karakteristikave kryesore të funksionimit të projektit

Funksionimi i projektit për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, bazohet në operacione minerare sipërfaqësore, pa përfshirë procese të përpunimit industrial në lokacionin e eksploatimit. Aktiviteti zhvillohet përmes një procesi të thjeshtë pune, i cili përfshin:

- Minimimin e masës shkëmbore të gurit gëlqeror përmes minimeve të kontrolluara;
- Ngarkimin e materialit të nxjerrë me ekskavator në kamionë transportues;
- Transportimin e gurit gëlqeror drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit të kompanisë.

Operimi realizohet me përdorimin e makinerive të rënda minerare, pajisjeve për shpim dhe minime, ekskavatorëve dhe kamionëve transportues. Aktiviteti zhvillohet në nivele të planifikuara të eksploatimit, në përputhje me projektin minerar dhe kushtet e sigurisë teknike. Funksionimi i projektit karakterizohet nga ndikime tipike për aktivitete minerare sipërfaqësore, si gjenerimi i pluhurit gjatë minimumit, ngarkimit dhe transportit, zhurma dhe vibrimet nga shpërthimet dhe makineritë, si dhe ndryshimi progresiv i konfiguracionit të terrenit. Operimi do të organizohet në mënyrë të kontrolluar, me zbatim të masave për siguri teknike dhe mbrojtje mjedisore, si dhe me planifikim për rehabilitim progresiv të zonës së eksploatuar.

2.4.Përshkrimi detal i procesit të planifikimit të prodhimit, duke filluar nga hyrja e lëndëve të para deri te produkti përfundimtar

Në kuadër të projektit për eksploatin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, procesi nuk përfshin përpunim industrial në lokacionin e eksploatimit. Aktiviteti përbëhet nga operacione minerare sipërfaqësore, ku materiali kryesor është masa shkëmbore e gurit gëlqeror që nxirret përmes minimit të kontrolluar. Procesi zhvillohet në këto faza kryesore:

- **Minimi i gurit gëlqeror** - Minimi realizohet në mënyrë sipërfaqësore, sipas planit minerar të miratuar. Procesi përfshin shpimin e vrimave në masën shkëmbore dhe realizimin e shpërthimeve të kontrolluara për fragmentimin e gurit gëlqeror. Shpërthimet kryhen duke respektuar parametrat teknikë të sigurisë, distancat mbrojtëse dhe masat për kontrollimin e vibrimeve, zhurmës dhe pluhurit.
- **Ngarkimi i materialit në kamionë** - Pas minimit dhe fragmentimit të masës shkëmbore, materiali i nxjerrë ngarkohet me ekskavator ose ngarkues në kamionë transportues. Gjatë kësaj faze sigurohet stabiliteti i frontit të punës dhe qarkullimi i sigurt i makinerive brenda zonës së eksploatimit.
- **Transportimi i gurit gëlqeror** - Guri gëlqeror i nxjerrë transportohet me kamionë drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Në zonën e eksploatimit nuk realizohet proces i thërrmimit, separimit apo përpunimit të mëtejshëm të materialit.

Planifikimi i këtij procesi bëhet në baza vjetore dhe mujore, në përputhje me kapacitetin e miratuar të nxjerrjes dhe kërkesën e tregut. Operacionet organizohen në mënyrë progresive, duke respektuar stabilitetin e skarpave, sigurinë teknike dhe masat për mbrojtjen e mjedisit. Ky model operimi paraqet proces minerar sipërfaqësor, me ndikime tipike që lidhen me ndryshimin e relievit, gjenerimin e pluhurit, zhurmën dhe vibrimet, të cilat trajtohen përmes masave të parashikuara në këtë raport.

2.5.Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme

Për realizimin e projektit për eksploatin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, nevojiten burime materiale, teknike dhe njerëzore që lidhen drejtpërdrejt me procesin e minimit, ngarkimit dhe transportit të materialit.

- **Burimi minerar** - Burimi kryesor është masa shkëmbore e gurit gëlqeror brenda zonës së eksploatimit, e cila do të shfrytëzohet sipas planit minerar dhe rezervave të miratuara.
- **Karburanti** - Makineritë që përdoren gjatë procesit, përfshirë pajisjet për shpim, ekskavatorët, ngarkuesit dhe kamionët transportues, funksionojnë kryesisht me naftë.

Konsumi i karburantit varet nga dinamika e punës, kapaciteti i planifikuar i nxjerrjes dhe distanca e transportit deri te impianti i thërrmimit dhe separimit.

- **Eksplozivi dhe mjete eksplozive** - Procesi i minimit të gurit gëlqeror realizohet përmes shpërthimeve të kontrolluara. Për këtë qëllim përdoren eksplozivë dhe mjete eksplozive të përshtatshme, sipas projektit të minimit dhe kushteve teknike të sigurisë. Sasia e eksplozivit përcaktohet në bazë të vëllimit të planifikuar për nxjerrje dhe karakteristikave gjeologjike të masës shkëmbore.
- **Makineritë dhe pajisjet** - Për zhvillimin e aktivitetit përdoren pajisje për shpim, ekskavatorë ose ngarkues për mbushjen e materialit dhe kamionë për transport. Këto mjete janë të domosdoshme për realizimin e procesit të minimit, nxjerrjes dhe dërgimit të gurit gëlqeror drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit të kompanisë.
- **Burimet njerëzore** - Projekti realizohet nga personel i trajnuar dhe i kualifikuar për operacione minerare, përfshirë staf teknik mbikëqyrës, operatorë të makinerive, shoferë të kamionëve dhe persona përgjegjës për sigurinë gjatë minimit dhe operimit në zonën e eksplotimit.

2.6.Vlerësimi i gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik

Në kuadër të projektit për eksplotimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, aktiviteti përfshin vetëm minimin e gurit gëlqeror, ngarkimin e materialit në kamionë dhe transportimin e tij drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Gjatë këtij procesi nuk gjenerohen mbeturina industriale apo mbetje nga përpunimi, pasi në zonën e eksplotimit nuk zhvillohet proces i thërrmimit, separimit apo përpunimit teknologjik të materialit. Mbeturinat që mund të krijohen janë kryesisht mbeturina komunale nga personeli gjatë qëndrimit në vendpunishte, si ambalazhe ushqimore, shishe plastike dhe mbetje të tjera të zakonshme. Sasia e mbeturinave komunale pritet të jetë e vogël dhe varet nga numri i punëtorëve dhe kohëzgjatja e operimit ditor. Këto mbeturina do të grumbullohen në kontejnerë të përshtatshëm dhe do të largohen përmes operatorit përkatës të menaxhimit të mbeturinave, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

2.7.Prezantimi i teknologjisë së trajtimi, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave

Gjatë eksplotimit të gurit gëlqeror nga kompania, nuk do të bëjë trajtim, përpunim, riciklim apo asgjësim të mbeturinave në lokacion. Aktiviteti përfshin vetëm minimin, ngarkimin dhe transportimin e gurit gëlqeror drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit të kompanisë.

Mbeturinat komunale që krijohen nga personeli gjatë punës do të grumbullohen veçmas në kontejnerë të përshtatshëm dhe do të merren nga kompania e kontraktuar për grumbullimin e mbeturinave nga Komuna, në përputhje me rregullat për menaxhimin e mbeturinave.

2.8. Programi për ndërtimin, kohëzgjatja e ndërtimit, kohëzgjatja e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit

Projekti për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, nuk përfshin fazë ndërtimi në kuptimin klasik të ndërtimit të objekteve industriale. Faza fillestare përbëhet nga punët përgatitore në terren, të cilat realizohen brenda një periudhe të shkurtër kohore, varësisht nga kushtet e terrenit dhe dinamika e punës.

- **Faza e punëve përgatitore** - Kjo fazë përfshin pastrimin e sipërfaqes, largimin e shtresës sipërfaqësore të tokës aty ku është e pranishme, rregullimin e terrenit dhe organizimin e rrugëve të brendshme për qarkullimin e makinerive dhe kamionëve. Kohëzgjatja e kësaj faze parashihet të jetë disa javë deri në 1 muaj.
- **Faza e operimit** - përfshin minimin e gurit gëlqeror, ngarkimin e materialit në kamionë dhe transportimin e tij drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Operimi zhvillohet në mënyrë progresive, sipas planit minerar dhe kapacitetit të miratuar të nxjerrjes. Kohëzgjatja e aktivitetit varet nga rezervat minerare, lejet përkatëse dhe dinamika e shfrytëzimit, dhe mund të zgjasë disa vite deri në shfrytëzimin e plotë të zonës së planifikuar.
- **Faza e rehabilitimit** - Pas përfundimit të eksploatimit në pjesë të caktuara të zonës, do të realizohet rehabilitimi progresiv i sipërfaqes së shfrytëzuar. Rehabilitimi përfshin:
 - Reformësimin e terrenit dhe stabilizimin e skarpave;
 - Shpërndarjen e shtresës së ruajtur të tokës sipërfaqësore;
 - Rikultivimin e sipërfaqes me bimësi të përshtatshme sipas kushteve lokale.

Rehabilitimi do të realizohet në përputhje me planin minerar, planin e mbylljes së zonës së eksploatimit dhe kërkesat e autoriteteve kompetente, me qëllim që zona e shfrytëzuar të kthehet në gjendje të qëndrueshme, të sigurt dhe të përshtatshme për mjedisin përreth.

2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Për realizimin e projektit për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, nevojitet infrastrukturë bazë që lidhet drejtpërdrejt me zhvillimin e procesit të minimit, ngarkimit dhe transportit të materialit. Brenda zonës së eksploatimit parashihen rrugë të brendshme për lëvizjen e makinerive, ekskavatorëve dhe kamionëve transportues. Këto rrugë do të sistemohen dhe mirëmbahen në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim sigurimin e qarkullimit të sigurt dhe efikas gjatë operimit. Zona e eksploatimit ka qasje në rrugën ekzistuese, e cila mundëson lidhjen me rrjetin rrugor lokal dhe transportimin e gurit gëlqeror drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Brenda sipërfaqes së shfrytëzimit do të përcaktohen zonat aktive të minimit, hapësirat për manovrim të makinerive dhe zona të përkohshme për parkimin e pajisjeve. Makineritë do të furnizohen me naftë sipas nevojës operative, në mënyrë të organizuar nga kompania dhe në përputhje me rregullat e sigurisë. Projekti nuk kërkon instalim të infrastrukturës për furnizim me ujë industrial, kanalizim apo energji elektrike, pasi në lokacion nuk realizohet proces i përpunimit teknologjik të materialit.

2.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave

Në kuadër të projektit për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, nuk parashihet ndërtimi i kampeve, rezidencave apo objekteve të përhershme për akomodim të punëtorëve. Aktiviteti zhvillohet në kushte të hapura minerare dhe operimi realizohet nga personel i angazhuar në baza ditore. Punëtorët nuk qëndrojnë në lokacion jashtë orarit të punës dhe nuk ka nevojë për infrastrukturë banimi apo struktura të përkohshme rezidenciale.

2.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin

Për eksploatimin e gurit gëlqeror investitori është i obliguar të pajiset me lejet dhe autorizimet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Lejet dhe licencat kryesore që kërkohen për zbatimin e projektit përfshijnë:

1. **Pëlqimi komunal** nga Komuna e Suharekës për aktivitetin/lokacionin, sipas kompetencave komunale.
2. **Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM)** dhe vendimi për VNM nga MMPHI.
3. **Licenca nga KPMM**
4. **Leja Mjedisore** nga MMPHI për operimin e aktivitetit.

2.12. Informacion për ndërlidhjen e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese

Projekti për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, ndërlidhet funksionalisht me impiantin e planifikuar të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Materiali i nxjerrë nga zona e eksploatimit, pas minimit dhe ngarkimit në kamionë, do të transportohet drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit, i cili parashihet të ndërtohet nga kompania për përpunimin mekanik të gurit gëlqeror. Në këtë impiant do të realizohet thërrmimi, separimi dhe klasifikimi i materialit sipas fraksioneve të nevojshme. Aktualisht, në zonën e eksploatimit aktiviteti kufizohet në minimin, ngarkimin dhe transportimin e gurit gëlqeror. Përveç ndërlidhjes me impiantin e planifikuar të thërrmimit dhe separimit të kompanisë, nuk parashihen ndërlidhje të tjera të drejtpërdrejta me projekte apo aktivitete të tjera ekzistuese.

3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT TË PROPOZUAR

3.1. Të dhënat për emrin e lokacionit ku është planifikuar të zbatohet projekti

Projekti për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K. është planifikuar të zbatohet në lokacionin e Bllacës, Komuna e Suharekës. Zona e projektit përfshin ngastrat kadastrale me numër:

- P-72116003-04427-0,
- P-72116003-04428-0,
- P-72116003-04429-0,
- P-72116003-04430-0,
- P-72116003-04431-0,
- P-72116003-04441-0
- P-72116003-04442-0, të gjitha në Zonën Kadastrale Bllacë, Komuna e Suharekës.

Sipas dokumentacionit të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis e Komunës së Suharekës, parcelat e lartcekura janë të përfshira në zonën ku lejohet zhvillimi i veprimtarive për infrastrukturë rrugore dhe zonë pyjore, në shfrytëzim të lejuar të veçantë për aktivitete të pasurive nëntokësore dhe sipërfaqësore. Lokacioni i projektit gjendet brenda territorit administrativ të Komunës së Suharekës, në Zonën Kadastrale Bllacë, dhe është i përcaktuar për zhvillimin e aktivitetit minerar të eksploatimit të gurit gëlqeror, në përputhje me dokumentacionin kadastral, kushtet urbanistike dhe pëlqimet përkatëse të lëshuara nga autoritetet kompetente.

3.2. Skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit

Vendndodhja e projektit për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, është paraqitur përmes skicës dhe planimetrisë përkatëse, të cilat ilustrojnë shtrirjen hapësinore të projektit në nivel kombëtar, komunal dhe lokal. Në hartën orientuese në nivel të Republikës së Kosovës paraqitet pozicioni i lokacionit në pjesën jugperëndimore të vendit, përkatësisht në territorin e Komunës së Suharekës. Kjo paraqitje mundëson identifikimin e qartë të vendndodhjes së projektit në kontekstin më të gjerë gjeografik. Në paraqitjen komunal dhe lokale është theksuar Zona Kadastrale Bllacë, ku ndodhen ngastrat kadastrale në të cilat planifikohet eksploatimi i gurit gëlqeror. Harta tregon shtrirjen e projektit brenda territorit administrativ të Komunës së Suharekës, si dhe raportin e tij me vendbanimin Bllacë, rrugët ekzistuese, sipërfaqet pyjore dhe aktivitetet përreth. Në planimetrinë lokale janë paraqitur parcelat ku do të bëhet eksploatimi i gurit gëlqeror, të evidentuara me sipërfaqe të theksuar. Kjo paraqitje tregon kufijtë e zonës së projektit, shtrirjen e parcelave brenda zonës kadastrale dhe lidhjen hapësinore të lokacionit me zonën përreth. Skica dhe planimetria shërbejnë si bazë për identifikimin e zonës së ndikimit dhe për vlerësimin e kushteve mjedisore në lokacion.




Figura 1. Shtrirja hapësinore e Lokacionit të projektit në territorin e Komunës së Suharekës

Në skicat përkatëse është paraqitur gjithashtu lidhja rrugore e lokacionit të projektit me qytetin e Suharekës dhe vendbanimet përreth, përmes rrjetit ekzistues rrugor.




Figura 2. Distanca e kompanisë me qytetin e Suharekës

3.3. Distancën me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti

Zona e projektit për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, ndodhet jashtë perimetrit të drejtpërdrejtë të qendrave të banuara. Sipas paraqitjes hartografike, lokacioni i projektit është i pozicionuar në zonë kryesisht pyjore dhe minerare, me distancë të konsiderueshme nga vendbanimet më të afërta. Vendbanimi më i afërt është Bllaca, e cila ndodhet në distancë rreth 1.02 km deri 1.18 km nga zona e projektit, varësisht nga pika e matjes. Ndërsa vendbanimi Nishor ndodhet në distancë rreth 2.05 km nga lokacioni i projektit.




Figura 3. Distanca e Kompanisë nga Shtëpi Bani

3.4.Paraqitje e karakteristikat pedologjike, geomorfologjike, gjeologjike, hidrogeologjike dhe sizmologjike të terrenit

Komuna e Suharekës karakterizohet me llojllojshmëri të theksuar natyrore, ku përfshihen zona fushore, kodrinore dhe malore. Territori i komunës paraqet kushte të ndryshme pedologjike, geomorfologjike, gjeologjike dhe hidrogeologjike, të cilat janë rezultat i ndërtimit gjeologjik, relievit, rrjedhave ujore dhe proceseve natyrore të zhvilluara gjatë kohës. Nga aspekti pedologjik, në këtë territor paraqiten grupe të ndryshme të tokave, të cilat i japin komunës pamje mozaike pedologjike. Përveç tokave skeletore, të cilat paraqiten në vendet shkëmbore, tokat tjera janë formuar nga sedimente liqenore, bartje lumore dhe depozitime të reja nga rrjedhat ujore. Në territorin e komunës hasen edhe pseudoglejet, të cilat paraqiten në sipërfaqe më të kufizuara dhe kanë bonitet kryesisht të klasës IV–VI. Po ashtu, përgjatë luginave të lumenjve janë të pranishme tokat aluviale, të cilat konsiderohen ndër tokat më produktive për bujqësi. Tokat bujqësore të kategorive I, II, III dhe IV kanë rëndësi të veçantë dhe përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të sipërfaqes së komunës. Nga aspekti geomorfologjik, Komuna e Suharekës shtrihet ndërmjet pjesëve kodrinore e malore dhe hapësirave më të ulëta fushore që lidhen me Rrafshin e Dukagjinit dhe fushën e Prizrenit. Terreni në pjesë të ndryshme të komunës paraqitet me shpate, ngritje kodrinore, lugina lumore dhe sipërfaqe më të rrafshëta. Në veri dhe lindje të komunës terreni ka ngritje më të theksuar, ndërsa në drejtim të jugut dhe perëndimit hapen sipërfaqe më të përshtatshme për zhvillim bujqësor dhe vendbanime. Kushtet geomorfologjike në përgjithësi janë të ndryshme, por të përshtatshme për zhvillim të kontrolluar, duke marrë parasysh pjerrësitë, stabilitetin e terrenit dhe rrezikun nga erozioni. Nga aspekti gjeologjik, Komuna e Suharekës ka ndërtim të ndryshëm gjeologjik. Pjesët veriore të komunës përbëhen kryesisht nga mergel, argjilë, argjilë me thëngjill, gëlqerorë dhe formacione të tjera sedimentare. Në rrethinën e Carralevës paraqiten formacione të flishit të shkumësit të epërm, ndërsa në disa pjesë hasen edhe diabaz, serpentine dhe peridotite të serpentinizuara. Në pjesën juglindore të komunës paraqiten rrasat e gjelbërta, metabazite, amfibolite, ndërsa në jug hasen edhe gëlqerorë dhe dolomite. Kjo përbërje gjeologjike tregon se komuna ka potencial të konsiderueshëm për materiale minerale dhe ndërtimore, përfshirë edhe gurin gëlqeror. Nga aspekti hidrogeologjik dhe hidrografik, Komuna e Suharekës ka rrjet të zhvilluar të lumenjve dhe përroskave. Rrjedhat ujore kanë karakter kryesisht malor dhe sezonal, me ndryshime të mëdha të prurjeve gjatë vitit. Në periudhat e thata disa rrjedha kanë pak ujë ose thahen, ndërsa gjatë reshjeve intensive mund të shkaktojnë vërshime lokale. Lumi kryesor i komunës është Toplluha, i cili formohet nga burimet dhe përroskat që vijnë nga Qafa e Duhlës, Malet e Budakovës, Pagarusha dhe Nishori. Toplluha është degë e majtë e Drinit të

Bardhë dhe paraqet arterien kryesore hidrografike të komunës. Përveç tij, rëndësi kanë edhe lumi i Sopisë, Lumi i Bardhë, Lumi i Bllacës dhe disa përroska lokale. Në aspektin hidrogeologjik, terrenet me gëlqerorë, dolomite dhe formacione të çara mundësojnë qarkullim të ujërave nëntokësore, ndërsa zonat me argjilë dhe mergel kanë përshkueshmëri më të ulët. Nga aspekti sizmologjik, Komuna e Suharekës, sikurse pjesa më e madhe e territorit të Kosovës, ndodhet në zonë me aktivitet sizmik të mundshëm. Rajoni jugperëndimor i Kosovës lidhet me ndikime tektonike rajonale, prandaj gjatë planifikimit të ndërtimeve, zhvillimeve infrastrukturore dhe aktiviteteve minerare duhet të merren parasysh kushtet e stabilitetit të terrenit, pjerrësitë, përbërja gjeologjike dhe masat për siguri teknike. Në zonat kodrinore dhe malore vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet stabilitetit të skarpave, erozionit dhe rrëshqitjeve të mundshme të tokës.

3.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë

Në kuadër të projektit për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, nuk parashihet përdorim i ujit për proces pune. Aktiviteti përfshin vetëm minimin e gurit gëlqeror, ngarkimin e materialit në kamionë dhe transportimin e tij drejt impiantit të planifikuar të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Në lokacion nuk zhvillohet proces teknologjik i përpunimit që kërkon furnizim të vazhdueshëm me ujë industrial.

3.6. Paraqitja e karakteristikave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik

Komuna e Suharekës karakterizohet me klimë kontinentale me ndikim mesdhetar, për shkak të pozitës së saj në pjesën jugore të Kosovës dhe afërsisë me rajonin e Prizrenit. Kjo klimë shprehet me vera relativisht të ngrohta dhe të thata, dimra të ftohtë, si dhe reshje të shpërndara gjatë vitit. Sipas të dhënave të PZHK-së së Suharekës, temperatura mesatare vjetore e ajrit në Suharekë është rreth 11°C, ndërsa maksimumi absolut paraqitet në muajin gusht me 38.2°C. Lagështia mesatare relative vjetore e ajrit në Suharekë është rreth 74.3%, ndërsa lagështia më e ulët paraqitet gjatë muajit gusht, me rreth 63.2%. Vranësira mesatare vjetore është rreth 5.0 të dhjetat e qiellit, ndërsa vranësira më e ulët paraqitet në muajin gusht, me vlerë rreth 2.7. Sa i përket reshjeve, Komuna e Suharekës ka regjim të reshjeve që ndikohet nga pozita gjeografike, relievi dhe afërsia me zonat malore. Reshjet janë më të theksuara gjatë periudhave të lagështa të vitit, ndërsa gjatë verës mund të paraqiten periudha më të thata. Për zonat urbane të Suharekës, në dokumentacionin planifikues janë përdorur vlera mesatare shumëvjeçare të reshjeve prej rreth 593 mm/vit, ndërsa në studime agroklimatike për zonën e Suharekës përmenden edhe vlera rreth 695 mm/vit, varësisht nga periudha dhe metodologjia e matjes.

Këto karakteristika klimatike janë të rëndësishme për vlerësimin e ndikimeve mjedisore, sidomos për projektet minerare dhe aktivitetet në terren të hapur. Temperaturat e larta dhe periudhat e thata mund të ndikojnë në rritjen e pluhurit gjatë lëvizjes së makinerive dhe transportit, ndërsa reshjet intensive mund të ndikojnë në rrjedhjet sipërfaqësore, erozionin dhe bartjen e materialit të imët nga sipërfaqet e hapura. Për këtë arsye, gjatë operimit duhet të zbatohen masa për lagjen e rrugëve të brendshme, menaxhimin e ujërave atmosferike dhe stabilizimin e sipërfaqeve të ekspozuara.

3.7. Prezantimi i karakteristikat natyrore

Komuna e Suharekës karakterizohet me kushte të larmishme natyrore, ku ndërthuren zona fushore, kodrinore dhe malore. Territori i komunës përfshin sipërfaqe bujqësore, pyjore, kullosa, rrjedha ujore dhe zona me vlera natyrore e peizazhore. Këto karakteristika e bëjnë komunën të rëndësishme si për zhvillim ekonomik, ashtu edhe për ruajtjen e mjedisit natyror. Në pjesët më të ulëta dhe fushore të komunës dominojnë tokat bujqësore dhe vendbanimet, ndërsa në pjesët kodrinore dhe malore paraqiten sipërfaqe pyjore, terrene me pjerrësi dhe zona natyrore më pak të urbanizuara. Sipas PZHK-së së Suharekës, në planifikimin zhvillimor të komunës rëndësi e veçantë i kushtohet mbrojtjes së resurseve natyrore, tokës bujqësore, pyjeve, ujërave dhe llojllojshmërisë së peizazheve natyrore. Rrjeti hidrografik i komunës përbëhet nga lumi Toplluha dhe degët e tij, si dhe nga përroska e rrjedha më të vogla sezonale. Këto rrjedha kanë rëndësi për ekuilibrin natyror, bujqësinë dhe kullimin e ujërave sipërfaqësore. Në periudhat me reshje intensive mund të paraqiten prurje më të larta, ndërsa gjatë periudhave të thata disa rrjedha kanë prurje të ulët. Bimësia natyrore është e lidhur ngushtë me relievin dhe llojin e tokës. Në zonat kodrinore dhe malore paraqiten kryesisht sipërfaqe pyjore dhe shkurre, ndërsa në zonat më të ulëta dominojnë kultura bujqësore, livadhe dhe sipërfaqe të shfrytëzuara nga banorët lokalë. Fauna është tipike për zonat rurale, pyjore dhe kodrinore të Kosovës, me prani të shpendëve, gjitarëve të vegjël, zvarranikëve dhe llojeve të tjera të përshtatura me këto habitate.

3.8. Rishikimi i karakteristikat themelore të peizazhit

Peizazhi i Komunës së Suharekës ka karakter të përzier rural, bujqësor, kodrinor dhe malor. Në pjesët e ulëta të komunës dominojnë fushat bujqësore, vendbanimet dhe infrastruktura rrugore, ndërsa në pjesët më të ngritura paraqiten shpate kodrinore, sipërfaqe pyjore, kullosa dhe zona natyrore me ndikim më të ulët urban. Karakteri i peizazhit ndryshon nga zona në zonë. Në afërsi të vendbanimeve peizazhi është më i ndikuar nga aktivitetet njerëzore, si

bujqësia, banimi, rrugët dhe objektet ekonomike. Në zonat kodrinore dhe pyjore peizazhi ruan karakter më natyror, me pamje të hapura, relief të thyer dhe mbulesë bimore më të dendur. PZHK e Suharekës e trajton ruajtjen e llojllojshmërisë së peizazheve natyrore si pjesë të rëndësishme të planifikimit hapësinor dhe mjedisor të komunës. Kjo nënkupton se gjatë zhvillimit të projekteve duhet të merren parasysh ndikimet vizuale, ndryshimi i relievit, dëmtimi i sipërfaqeve pyjore dhe ruajtja e harmonisë së peizazhit me mjedisin përreth. Në zonat ku zhvillohen aktivitete minerare, peizazhi mund të pësojë ndryshime si rezultat i hapjes së fronteve të punës, largimit të vegjetacionit, krijimit të rrugëve të brendshme dhe ndryshimit të konfiguracionit natyror të terrenit. Për këtë arsye, rëndësi të veçantë ka planifikimi i eksploatimit në mënyrë progresive, stabilizimi i skarpave dhe rehabilitimi gradual i sipërfaqeve të shfrytëzuara.

3.9. Rishikimi i objektet e mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike

Në zonën ku do të bëhet eksploatimi i gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, nuk janë identifikuar objekte të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike brenda ngastrave të projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të tyre. Aktiviteti i projektit do të zhvillohet në zonë minerare dhe pyjore, jashtë zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore. Në rast se gjatë punimeve hasen gjurmë apo elemente të mundshme arkeologjike, kompania duhet të ndërpresë punimet në atë pjesë dhe të njoftojë institucionet kompetente për trashëgimi kulturore.

3.10. Të dhënat për popullsinë, përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar

Komuna e Suharekës ka karakter kryesisht urban, rural dhe bujqësor, me popullsi të shpërndarë në qytetin e Suharekës dhe në vendbanimet përreth. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në regjistrimin e vitit 2011 Komuna e Suharekës kishte 59,722 banorë, ndërsa sipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2024 popullsia ka shënuar rënie në rreth 45,749 banorë. Nga aspekti demografik, komuna karakterizohet me vendbanime rurale dhe urbane, me aktivitete ekonomik të lidhur kryesisht me bujqësinë, tregtinë, shërbimet, ndërtimtarinë dhe veprimtaritë prodhuese. Projekti i planifikuar nuk pritet të shkaktojë zhvendosje të popullsisë apo ndryshim të strukturës demografike të zonës. Ndikimi kryesor i mundshëm lidhet me shqetësimet e përkohshme gjatë operimit, të cilat do të menaxhohen përmes masave për kontrollin e pluhurit, zhurmës, vibrimeve dhe qarkullimit të kamionëve.

3.11. Të dhëna për objektet ekzistuese

Në afërsi të drejtpërdrejtë të lokacionit ku planifikohet eksploatimi i gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, nuk ka objekte banimi apo objekte të tjera të ndjeshme. Shtëpitë më të afërta të banimit ndodhen në distancë më të madhe se 1 km nga zona e projektit, prandaj ndikimet e drejtpërdrejta nga aktiviteti minerar në popullsinë lokale pritet të jenë të kufizuara.

3.12. Në varësi të karakteristikave të zonës, përshkrimi i lokacionit përmban edhe të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme

Bazuar në dokumentacionin planifikues në fuqi, gjendjen ekzistuese në terren dhe të dhënat në dispozicion për lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, në hapësirën ku planifikohet eksploatimi i gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., nuk janë identifikuar zona të përcaktuara për kërkime shkencore, vende arkeologjike të regjistruara, zona veçanërisht të ndjeshme mjedisore apo zona me qëllime të veçanta brenda ngastrave të projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të tyre. Lokacioni ka karakter kryesisht minerar dhe pyjor, ndërsa aktiviteti i planifikuar kufizohet në minimin, ngarkimin dhe transportimin e gurit gëlqeror. Në rast se gjatë zhvillimit të punimeve hasen gjurmë të mundshme arkeologjike apo elemente me vlerë të veçantë natyrore ose kulturore, punimet duhet të ndërpriten përkohësisht dhe të njoftohen institucionet kompetente.

3.13. Të dhënat për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dh në afësi të saj

Sipas paraqitjes hartografike, rrjedha ujore më e afërt është Lumi Mirushë, i cili ndodhet në distancë rreth 1.24 km nga zona e projektit. Kjo distancë konsiderohet e mjaftueshme për të kufizuar ndikimet e drejtpërdrejta në rrjedhën ujore, pasi aktiviteti në lokacion përfshin vetëm minimin, ngarkimin dhe transportimin e gurit gëlqeror. Gjatë operimit nuk parashihet përdorim i ujit për proces teknologjik dhe nuk do të ketë shkarkime të ujërave industriale.

4. GJENDJA AKTUALE E FAKTORËVE MJEDISOR

4.1. Raport për gjendjen aktuale të faktorëve mjedisor

Gjendja aktuale e faktorëve mjedisorë paraqitet e ndikuar nga zhvillimi urban, trafiku rrugor, aktivitetet ekonomike, bujqësia, shfrytëzimi i tokës, si dhe nga kushtet natyrore të territorit. Komuna e Suharekës karakterizohet me zona urbane, rurale, bujqësore, kodrinore dhe malore, ku ndikimet mjedisore ndryshojnë varësisht nga pozita, intensiteti i aktiviteteve dhe mënyra e shfrytëzimit të hapësirës. Në territorin e Komunës së Suharekës, cilësia e ajrit ndikohet kryesisht nga trafiku rrugor, ngrohja individuale gjatë sezonit dimëror, aktivitetet ekonomike dhe lëvizja e mjeteve të rënda përgjatë akseve kryesore rrugore. Ndotja është më e theksuar në zonën urbane të Suharekës dhe përgjatë rrugëve kryesore, ndërsa në zonat rurale, kodrinore dhe pyjore niveli i ndotjes është më i ulët. Sa i përket ujërave sipërfaqësore, Komuna e Suharekës ka rrjet hidrografik të përfaqësuar nga lumi Toplluha dhe degët e tij, përroska lokale dhe rrjedha sezonale. Gjendja e ujërave sipërfaqësore ndikohet nga shkarkimet urbane, aktivitetet bujqësore, rrjedhjet sipërfaqësore gjatë reshjeve dhe erozioni. Në periudhat me reshje intensive mund të paraqitet bartje e materialeve të imëta në rrjedhat ujore, ndërsa gjatë periudhave të thata disa përroska kanë prurje të ulët ose karakter sezonal. Nga aspekti i tokës, Komuna e Suharekës karakterizohet me përbërje të ndryshme pedologjike. Në zonat fushore dhe përgjatë luginave paraqiten toka më produktive, të përshtatshme për bujqësi, ndërsa në zonat kodrinore dhe malore dominojnë toka më të cekëta, skeletore dhe me pjellori më të kufizuar. Në disa pjesë të komunës toka është e ndikuar nga erozioni, shfrytëzimi bujqësor, ndërtimet dhe aktivitetet ekonomike. Biodiversiteti në Komunën e Suharekës është i lidhur me sipërfaqet pyjore, kullosat, tokat bujqësore, rrjedhat ujore dhe zonat kodrinore e malore. Pyjet paraqesin resurs të rëndësishëm natyror dhe ekologjik, duke krijuar kushte për zhvillimin e florës dhe faunës lokale. Në këto zona mund të hasen shpendë, gjitarë të vegjël, zvarranikë dhe lloje të tjera karakteristike për mjediset rurale, pyjore dhe kodrinore të Kosovës. Ndotja akustike në Komunën e Suharekës është më e theksuar në zonat urbane, përgjatë rrugëve kryesore dhe në afërsi të aktiviteteve ekonomike. Në zonat rurale, bujqësore dhe pyjore niveli i zhurmës është më i ulët dhe lidhet kryesisht me qarkullimin lokal, aktivitetet bujqësore dhe veprimtaritë e kufizuara ekonomike. Gjendja aktuale e faktorëve mjedisorë në Komunën e Suharekës paraqet një mjedis me vlera natyrore, bujqësore dhe pyjore, por edhe me zhvillimi urban, infrastruktura, bujqësia dhe aktivitetet ekonomike. Për këtë arsye, çdo zhvillim i ri duhet të planifikohet duke marrë parasysh mbrojtjen e ajrit, ujërave, tokës, biodiversitetit, peizazhit dhe cilësisë së jetës së popullsisë.

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË PROJEKTIT

5.1. Përshkrimi i alternativave të realizueshme

Në kuadër të projektit për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, janë shqyrtuar këto alternativa të realizueshme, duke u bazuar në formatin dhe përmbajtjen e kërkuar për këtë kapitull.

- A. **Eksplotimi i gurit gëlqeror në lokacionin e propozuar** - Kjo alternativë parasheh zhvillimin e aktivitetit minerar në ngastrat e planifikuara në Zonën Kadastrale Bllacë, Komuna e Suharekës. Aktiviteti përfshin minimin e gurit gëlqeror, ngarkimin e materialit në kamionë dhe transportimin e tij drejt impiantit të planifikuar të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Kjo alternativë siguron shfrytëzim racional të resurseve minerare dhe mundëson zhvillimin e aktivitetit në një zonë të përshtatshme për këtë veprimtari.
- B. **Mosrealizimi i projektit** - Kjo alternativë nënkupton që aktiviteti i eksploatimit të gurit gëlqeror të mos realizohet. Në këtë rast nuk do të ketë ndikime të reja mjedisore nga minimi, transporti, pluhuri, zhurma apo ndryshimi i terrenit. Megjithatë, kjo alternativë do të pamundësonte shfrytëzimin e rezervave minerare, zhvillimin ekonomik të kompanisë dhe furnizimin me material gëlqeror për nevojat e tregut.
- C. **Zhvendosja e aktivitetit në një lokacion tjetër** - Kjo alternativë do të kërkonte identifikimin e një zone të re minerare, procedura të reja të lejeve, investime shtesë dhe ndërtim të infrastrukturës së re. Gjithashtu, do të krijonte ndikime të reja mjedisore në një territor tjetër dhe do të zgjaste kohën e realizimit të projektit.

Pas analizës së alternativave, alternativa A konsiderohet më e favorshme, pasi mundëson shfrytëzimin e gurit gëlqeror në lokacionin e propozuar, ka lidhje funksionale me impiantin e planifikuar të thërrmimit dhe separimit të kompanisë dhe siguron zhvillim të aktivitetit me ndikime të menaxhueshme mjedisore.

5.2. Përshkrimi i alternativave të realizueshme përmban edhe përshkrimin e arsyeve kryesore për zgjedhjen e një alternative të caktuar duke ju referuar:

Alternativa e propozuar, që parasheh eksploatimin e gurit gëlqeror në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, vlerësohet si më e përshtatshme, sepse siguron balancë ndërmjet realizueshmërisë teknike, ndikimit të kontrolluar mjedisor dhe qëndrueshmërisë ekonomike. Lokacioni ka qasje të përshtatshme në rrugët ekzistuese dhe ndërlidhet me impiantin e planifikuar të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Kjo mundëson organizim më efikas të procesit të minimit, ngarkimit dhe transportimit të materialit. Gjithashtu, vendndodhja është

jashtë perimetrit të drejtpërdrejtë të zonave të banuara, pasi shtëpitë më të afërta ndodhen në distancë më të madhe se 1 km. Kjo alternativë paraqet zgjidhjen më të qëndrueshme, me ndikime të menaxhueshme në tokë, ajër, zhurmë, vibrime dhe peizazh, me kusht që të zbatohen masat e përcaktuara në këtë raport

5.3.Vendndodhja ose rruga

Vendndodhja e projektit në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, vlerësohet si e përshtatshme për zhvillimin e aktivitetit të eksploatimit të gurit gëlqeror. Lokacioni gjendet në zonë kryesisht pyjore dhe minerare, jashtë qendrave të banuara dhe me qasje në rrjetin rrugor ekzistues. Rrugët ekzistuese mundësojnë hyrje dhe dalje të organizuar të kamionëve transportues, ndërsa brenda zonës së eksploatimit do të organizohen rrugë të brendshme për qarkullimin e makinerive dhe mjeteve të transportit. Materiali i nxjerrë do të transportohet drejt impiantit të planifikuar të thërmimit dhe separimit të kompanisë.

5.4.Ndikimet në mjedis dhe shëndetin e njeriut

Eksploatimi i gurit gëlqeror përfshin minimin, ngarkimin në kamionë dhe transportimin e materialit. Si i tillë, ndikimet në mjedis dhe në shëndetin e njeriut lidhen kryesisht me karakterin e aktivitetit minerar sipërfaqësor. Gjatë procesit të minimit dhe lëvizjes së kamionëve mund të gjenerohet pluhur, sidomos gjatë shpërthimeve, ngarkimit dhe qarkullimit në rrugët e brendshme. Po ashtu, makineritë që përdorin naftë mund të gjenerojnë gazra nga djegia e karburantit. Aktiviteti mund të shkaktojë ndryshim të relievit, largim të shtresës sipërfaqësore të tokës dhe ndikim vizual në peizazh. Zhurma dhe vibrimet krijohen kryesisht nga makineritë dhe shpërthimet e kontrolluara gjatë minimit. Duke qenë se shtëpitë e banimit ndodhen më shumë se 1 km larg, ndikimi në popullsi vlerësohet i kufizuar. Ndikimet potenciale në shëndetin e njeriut lidhen kryesisht me punëtorët që angazhohen në lokacion, për shkak të ekspozimit ndaj pluhurit, zhurmës dhe rreziqeve mekanike. Këto ndikime menaxhohen përmes përdorimit të pajisjeve mbrojtëse personale, zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe respektimit të standardeve teknike minerare.

5.5.Proceset dhe teknologjia e prodhimit

Në kuadër të projektit për eksploatimin e gurit gëlqeror nga “StoneX Holding” SH.P.K., nuk zhvillohet proces prodhimi në kuptimin industrial në lokacionin e eksploatimit. Aktiviteti përbëhet nga operacione minerare sipërfaqësore që përfshijnë nxjerrjen, ngarkimin dhe transportimin e materialit. Procesi i punës zhvillohet në këto faza kryesore:

- **Minimi i gurit gëlqeror** - Procesi fillon me shpimin e vrimave në masën shkëmbore, sipas planit minerar të miratuar. Pas shpimit, realizohen shpërthime të kontrolluara për fragmentimin e gurit gëlqeror.
- **Ngarkimi i materialit** - Pas fragmentimit, materiali i nxjerrë ngarkohet me ekskavator apo ngarkues në kamionë transportues. Operacioni zhvillohet në frontin e punës, duke siguruar stabilitetin e terrenit dhe qarkullimin e kontrolluar të mjeteve.
- **Transportimi i gurit gëlqeror** - Materiali transportohet me kamionë drejt impiantit të planifikuar të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Në zonën e eksploatimit nuk kryhet thërrmim, separim apo përpunim i mëtejshëm industrial.

5.6. Metodat e punës gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit

Aktiviteti i eksploatimit të gurit gëlqeror realizohet në mënyrë të organizuar, në përputhje me planin minerar dhe rregullat e sigurisë në punë. Procesi përfshin shpimin, minimin e kontrolluar, ngarkimin me ekskavator dhe transportin e materialit me kamionë drejt impiantit të planifikuar të thërrmimit dhe separimit. Operacionet kryhen nga personel i trajnuar dhe i pajisur me mjete mbrojtëse personale. Makineritë dhe pajisjet i nënshtrohen mirëmbajtjes së rregullt teknike, me qëllim funksionimin e sigurt dhe uljen e rrezikut për aksidente apo ndotje. Gjatë funksionimit zbatohen masa për kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe vibrimeve. Nuk përdoret ujë për proces teknologjik dhe nuk gjenerohen ujëra industriale. Mbeturinat komunale nga personeli grumbullohen në mënyrë të kontrolluar dhe largohen përmes sistemit komunal.

5.7. Plani i lokacionit

Plani i lokacionit për eksploatimin e gurit gëlqeror përfshin organizimin funksional të hapësirës minerare, në përputhje me planin e miratuar të minimit. Në plan parashihen:

- Zonat e punës ku realizohet minimi i gurit gëlqeror;
- Zonat për shpim dhe shpërthime të kontrolluara;
- Hapësirat për ngarkimin e materialit;
- Rrugët e brendshme për qarkullimin e kamionëve dhe makinerive;
- Zonat për manovrim dhe parkim të përkohshëm të pajisjeve.

Plani parashihet organizim të qartë të qarkullimit brenda zonës së eksploatimit, duke siguruar hyrje dhe dalje të kontrolluar të mjeteve transportuese drejt rrjetit rrugor ekzistues dhe drejt impiantit të planifikuar të kompanisë.

5.8.Llojin dhe përzgjedhjen e materialeve për realizimin e projektit

Për realizimin e projektit nuk parashihet ndërtim i objekteve industriale në zonën e eksploatimit. Aktiviteti kërkon përdorimin e pajisjeve dhe materialeve të përshtatshme për minimin sipërfaqësor të gurit gëlqeror. Procesi realizohet përmes përdorimit të pajisjeve për shpim, mjeteve plasëse për shpërthime të kontrolluara, ekskavatorëve apo ngarkuesve për mbushjen e materialit dhe kamionëve për transport. Si burim energjie përdoret karburanti dizel për funksionimin e makinerive. Guri gëlqeror i nxjerrë përbën materialin kryesor të projektit dhe transportohet për përpunim të mëtejshëm në impiantin e planifikuar të thërrmimit dhe separimit të kompanisë.

5.9.Afati kohor për ekzekutimin dhe përfundimin e funksionimit të projektit sipas legjislacionit

Projekti për eksploatimin e gurit gëlqeror nuk përfshin fazë ndërtimi të objekteve industriale, por vetëm punë përgatitore në terren. Këto punë parashihet të realizohen brenda një periudhe të shkurtër kohore, varësisht nga kushtet në terren dhe dinamika e organizimit të punës. Pas përfundimit të punëve përgatitore, aktiviteti i minimit do të zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me planin minerar, lejen përkatëse dhe kapacitetin e lejuar të nxjerrjes. Afati i operimit është i lidhur me rezervat minerare, vlefshmërinë e lejeve dhe përmbushjen e kërkesave ligjore, teknike dhe mjedisore. Pas përfundimit të eksploatimit, do të realizohet faza e mbylljes dhe rehabilitimit të zonës, në përputhje me planin e mbylljes dhe detyrimet e përcaktuara nga autoritetet kompetente.

5.10. Madhësia e lokacionit ose objektit

Zona për eksploatimin e gurit gëlqeror shtrihet në një sipërfaqe prej 78863 m². Kjo sipërfaqe përfshin zonat e sipërfaqeve të minimit, rrugët e brendshme dhe hapësirat për qarkullim dhe organizim të operimit, në përputhje me planin minerar të miratuar.

5.11. Vëllimi i prodhimit

Vëllimi i kapacitetit të planifikuar është 500 m³/dit.

5.12. Kontrolli i ndotjes

Për projektin e eksploatimit të gurit gëlqeror janë parashikuar masa për kontrollin e pluhurit, zhurmës, vibrimeve dhe ndikimeve të tjera mjedisore gjatë minimit dhe transportit. Kontrolli i pluhurit realizohet përmes mirëmbajtjes së rrugëve të brendshme, lagies së sipërfaqeve gjatë periudhave të thata dhe organizimit të duhur të qarkullimit të kamionëve. Shpërthimet realizohen në mënyrë të kontrolluar për të kufizuar përhapjen e pluhurit dhe vibrimeve. Zhurma dhe vibrimet menaxhohen përmes përdorimit të pajisjeve në gjendje të mirë teknike,

respektimit të orarit të punës dhe zbatimit të parametrave teknikë gjatë minimimit. Makineritë do të mirëmbahen rregullisht për të reduktuar emetimet nga motorët me naftë dhe për të parandaluar rrjedhjet e mundshme të karburantit apo vajrave.

5.13. Trajtimin e mbeturinave, përfshirë riciklimin, ripërdorimin, asgjësimin dhe deponimin përfundimtar

Në kuadër të projektit për eksploatimin e gurit gëlqeror nuk parashihet trajtim apo përpunim i mbeturinave industriale në lokacion, pasi aktiviteti përfshin vetëm minimin, ngarkimin dhe transportimin e materialit. Mbeturinat e vetme që mund të krijohen gjatë operimit janë mbeturinat komunale nga personeli. Këto do të grumbullohen në kontejnerë të përshtatshëm brenda lokacionit dhe do të largohen nga kompania e kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave, në përputhje me sistemin komunal.

5.14. Rregulimi i infrastrukturës rrugore të qasjes në projekt dhe rrugë të komunikacionit

Qasja në zonën e eksploatimit të gurit gëlqeror në lokalitetin Bllacë realizohet përmes rrjetit ekzistues rrugor, i cili mundëson hyrje dhe dalje të organizuar të kamionëve transportues. Brenda zonës së eksploatimit do të organizohen rrugë të brendshme për qarkullimin e makinerive dhe kamionëve, si dhe hapësira për manovrim, ngarkim dhe parkim të përkohshëm të pajisjeve. Projekti nuk kërkon ndërhyrje të mëdha infrastrukturore jashtë perimetrit të zonës së projektit, pasi shfrytëzohet infrastruktura ekzistuese rrugore dhe organizimi i qasjes.

5.15. Përgjegjësia dhe procedurat për menaxhimin e mjedisit

Kompania “StoneX Holding” SH.P.K. është përgjegjëse për respektimin e të gjitha kërkesave mjedisore gjatë realizimit të projektit për eksploatimin e gurit gëlqeror. Përgjegjësia përfshin zbatimin e masave për kontrollin e pluhurit, zhurmës dhe vibrimeve gjatë minimimit dhe transportit, menaxhimin e mbeturinave komunale, mirëmbajtjen e makinerive dhe parandalimin e rrjedhjeve të karburantit apo vajrave. Kompania është e obliguar të bashkëpunojë me autoritetet kompetente, të raportojë sipas kërkesave ligjore dhe të sigurojë që aktiviteti të zhvillohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, sigurinë në punë dhe veprimtarinë minerare.

5.16. Trajnimi

Personeli do të trajnohet për përdorimin e pajisjeve, sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mjedisit.

5.17. Monitorimi

Monitorimi i parametrave mjedisorë do të realizohet periodikisht, sipas kërkesave ligjore.

5.18. Planet për situata emergjente

Për projektin e propozuar duhet të parashihen plane të qarta për menaxhimin e situatave emergjente, me qëllim mbrojtjen e punëtorëve, popullsisë përreth, pronës dhe mjedisit. Situatat emergjente mund të paraqiten si rezultat i aksidenteve gjatë punës, prishjeve teknike të makinerive, rrjedhjeve të karburanteve dhe vajrave, zjarreve, lëndimeve të punëtorëve, kushteve të pafavorshme atmosferike, rrëshqitjeve të dheut apo rasteve të tjera të paparashikuara.

5.19. Demolimi dhe rehabilitimi

Pas përfundimit të aktivitetit të shfrytëzimit, investitori/operatori duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për demolimin e përkohshëm të strukturave ndihmëse, largimin e pajisjeve dhe rehabilitimin e zonës së shfrytëzuar. Qëllimi kryesor i kësaj faze është kthimi i lokacionit në një gjendje sa më të qëndrueshme dhe të pranueshme nga aspekti mjedisor, teknik dhe peizazhor.

Demolimi përfshin largimin e të gjitha pajisjeve, makinerive, materialeve ndihmëse, kontejnerëve, elementeve të përkohshme të punës dhe çdo materiali tjetër që nuk do të përdoret më pas përfundimit të aktivitetit. Të gjitha mbeturinat që krijohen gjatë kësaj faze duhet të grumbullohen, klasifikohen dhe transportohen në vende të autorizuar për trajtim apo deponim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbeturinave.

Gjatë demolimit duhet të shmanget ndotja e tokës dhe ujërave nga vajrat, karburantet, mbeturinat ndërtimore apo materialet tjera ndotëse. Makineritë duhet të përdoren me kujdes, ndërsa çdo rrjedhje eventuale duhet të izolohet dhe pastrohet menjëherë. Zona nuk duhet të lihet me mbeturina, materiale të shpërndara apo elemente që mund të paraqesin rrezik për njerëzit, kafshët ose mjedisin.

Rehabilitimi i lokacionit duhet të realizohet në mënyrë graduale dhe të planifikuar. Në zonat ku është bërë shfrytëzimi sipërfaqësor, duhet të bëhet stabilizimi i terrenit, rregullimi i pjerrësive, shmangia e skajeve të rrezikshme dhe krijimi i kushteve për rikthimin gradual të vegjetacionit. Nëse gjatë punimeve është larguar shtresa sipërfaqësore e tokës, ajo duhet të ruhet dhe të përdoret përsëri gjatë fazës së rikultivimit, aty ku është e mundur.

Masat kryesore të rehabilitimit përfshijnë rrafshimin dhe modelimin e terrenit, mbulimin e sipërfaqeve të ekspozuara me shtresë toke, mbjelljen e barit, shkurreve apo llojeve vendore të bimësisë, si dhe kontrollin e erozionit. Në zonat me pjerrësi më të madhe duhet të ndërmerren masa shtesë për stabilizim, me qëllim që të parandalohet rrëshqitja e materialit dhe bartja e sedimenteve gjatë reshjeve atmosferike.

Në rastet kur mbetet ndonjë gropë, zoan e shfrytëzimit apo sipërfaqe e pjerrët, ato duhet të sigurohen dhe të përshtaten në mënyrë që të mos paraqesin rrezik pas përfundimit të aktivitetit. Qasjet e panevojshme duhet të mbyllen, ndërsa rrugët që nuk do të përdoren më duhet të rehabilitohen ose të përshtaten sipas planit përfundimtar të lokacionit.

Rehabilitimi duhet të ketë për qëllim zvogëlimin e ndikimeve afatgjata në tokë, peizazh, florë, faunë dhe ujëra. Pas përfundimit të punimeve rehabilituese, operatori duhet të bëjë kontrollin e gjendjes së terrenit dhe të sigurohet që lokacioni është i pastër, i qëndrueshëm dhe nuk paraqet rrezik mjedisor.

Në përgjithësi, demolimi dhe rehabilitimi janë faza të rëndësishme për mbylljen e përgjegjshme të aktivitetit. Zbatimi i këtyre masave mundëson që zona e shfrytëzuar të kthehet gradualisht në gjendje të pranueshme, duke zvogëluar ndikimet vizuale, fizike dhe ekologjike të projektit pas përfundimit të operimit.

5.20. Plani për menaxhimin e mjedisit

Plani për menaxhimin e mjedisit përcakton masat që duhet të zbatohen gjatë zhvillimit të aktivitetit, me qëllim parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve të mundshme në mjedis. Operatorit i kërkohet që punimet të zhvillohen vetëm brenda kufijve të lejuar të projektit dhe në përputhje me kushtet teknike dhe ligjore.

Gjatë operimit duhet të zbatohen masa për kontrollin e pluhurit, zhurmës, vibrimeve, mbeturinave, ujërave atmosferike dhe mbrojtjen e tokës nga ndotja. Makineritë duhet të mirëmbahen rregullisht, ndërsa çdo rrjedhje e vajrave apo karburanteve duhet të pastrohet menjëherë. Mbeturinat duhet të grumbullohen, ndahen dhe dorëzohen te operatorët e autorizuar.

5.21. Përshkrimi i alternativës pa veprim

Alternativa pa veprim nënkupton rastin kur projekti nuk realizohet dhe lokacioni mbetet në gjendjen ekzistuese. Në këtë rast nuk do të ketë ndërhyrje të reja në terren, përdorim të makinerive, krijim të pluhurit, zhurmës, vibrimeve apo ndryshime në peizazh.

Nga aspekti mjedisor, kjo alternativë shmanget ndikimet e mundshme të projektit, por njëkohësisht nuk mundëson shfrytëzimin e resursit, zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të punës dhe përfitimet tjera që lidhen me realizimin e projektit.

6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË PROJEKTIT NË MJEDIS

6.1.Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përfshinë

Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve në mjedis përfshin analizen e ndikimeve që mund të shkaktojë zona e eksploatimit të gurit gëlqeor nga “StoneX Holding” SH.P.K. gjatë fazës së operimit. Vlerësimi është bazuar në dokumentacionin teknik të projektit, karakteristikat natyrore të zonës së komunes Suharekë dhe gjendjen ekzistuese mjedisore, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ndikimet janë analizuar në tre aspekte kryesore:

- **Aspektet fizike**, që përfshijnë ndikimet në ajër nga pluhuri gjatë minimit dhe transportit, zhurmën dhe vibrimet nga shpërthimet dhe makineritë, si dhe ndryshimin e relievit dhe përdorimin e burimeve;
- **Aspektet biologjike**, që lidhen me ndikimet e mundshme në vegjetacionin dhe mjedisin përreth brenda zonës së eksploatimit;
- **Aspektet socio-ekonomike**, që përfshijnë ndikimin në komunitetin lokal, punësimin dhe zhvillimin ekonomik.

Duke qenë se projekti përfshin vetëm minimin dhe transportin, pa përpunim industrial dhe pa përdorim uji, ndikimet mjedisore vlerësohen si lokale dhe të menaxhueshme. Ndikimet kryesore lidhen me pluhurin, zhurmën dhe ndryshimin e terrenit, të cilat do të kontrollohen përmes masave teknike dhe organizative të parashikuara në këtë raport. Qëllimi i vlerësimit është që aktiviteti të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar kërkesat ligjore dhe duke mbrojtur mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

6.2.Cilësinë e ajrit

Cilësia e ajrit në zonën e projektit mund të ndikohet përkohësisht nga aktivitetet minerare që zhvillohen gjatë operimit. Burimi kryesor i ndikimit është pluhuri që krijohet gjatë minimit të masës shkëmbore, gjatë shpërthimeve të kontrolluara, ngarkimit të materialit me ekskavator dhe lëvizjes së kamionëve në rrugët e brendshme të paasfaltuara. Një ndikim shtesë vjen edhe nga gazrat e djegies që lirohen nga makineritë dhe mjetet transportuese që përdorin naftë. Megjithatë, duke qenë se lokacioni ndodhet mbi 1 km larg qendrave të banuara dhe aktiviteti është i kufizuar në një zonë ekzistuese minerare, ndikimi në cilësinë e ajrit për popullsinë përreth vlerësohet i ulët dhe me shtrirje lokale.

6.3.Niveli dhe përqendrimin e substancave ndotëse në ajër dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standardet sipas legjislacionit në fuqi:

Substancat kryesore ndotëse që mund të paraqiten në ajër gjatë operimit të projektit janë pluhuri total dhe fraksionet e tij, si dhe emetimet nga djegia e karburantit në makineri dhe kamionë,

kryesisht CO₂, CO dhe oksidet e azotit NO_x. Duke pasur parasysh natyrën e aktivitetit, mungesën e përpunimit industrial në lokacion dhe faktin se projekti përfshin vetëm minimin dhe transportin, nuk priten përqendrimet të larta dhe të vazhdueshme të ndotësve në ajër jashtë perimetrit të zonës së punës. Përqendrimet e mundshme të ndotësve do të jenë më të theksuara pranë zonës së minimit dhe përgjatë rrugëve të brendshme, ndërsa në zonat përreth pritet të bien ndjeshëm si rezultat i shpërndarjes natyrore në hapësirë. Me zbatimin e masave për mirëmbajtjen teknike të makinerive, organizimin e duhur të punës dhe kontrollin e pluhurit, vlerësohet se ndikimi do të mbetet brenda kufijve të pranueshëm sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe normave përkatëse mjedisore.

6.4. Ndikimin e projektit në klimë, lloji dhe vëllimi i emetimeve të gazeve serrë dhe ndjeshmëria e projektit ndaj ndryshimeve klimatike:

Projekti nuk paraqet burim të rëndësishëm të emetimeve të gazeve serrë, pasi në lokacion nuk zhvillohet proces industrial, nuk ka djegie stacionare dhe nuk përdoret energji elektrike për procese prodhuese. Emetimet e gazeve serrë lidhen kryesisht me përdorimin e naftës nga makineritë minerare, pajisjet për shpim dhe kamionët transportues, të cilat gjenerojnë kryesisht CO₂ në sasi të varura nga intensiteti i punës dhe kohëzgjatja e operimit. Për shkak të karakterit lokal dhe të kufizuar të aktivitetit, vëllimi i emetimeve konsiderohet relativisht i ulët në raport me projekte industriale të përpunimit. Sa i përket ndjeshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike, projekti mund të ndikohet nga periudhat e thata dhe temperaturat e larta, të cilat mund të rrisin krijimin dhe përhapjen e pluhurit, si dhe nga reshjet intensive që mund të vështirësojnë operimin dhe qarkullimin në terren. Megjithatë, për shkak se aktiviteti zhvillohet në zonë të hapur dhe me organizim fleksibil të punës, projekti ka mundësi të menaxhojë këto kushte përmes masave organizative dhe teknike gjatë operimit.

6.5. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ajrit:

Bazuar në natyrën, madhësinë dhe shtrirjen e kufizuar të projektit, nuk pritet që aktiviteti i zgjerimit të zonës së eksploatimit të gurit gëlqeror të shkaktojë ndotje ndërkufitare të ajrit. Emetimet në ajër nga projekti janë të karakterit lokal dhe lidhen kryesisht me pluhurin dhe gazrat nga makineritë dhe kamionët brenda perimetrit të zonës së eksploatimit. Këto ndikime shpërndahen në distancë të shkurtër dhe nuk kanë potencial për përhapje në shkallë rajonale apo ndërkufitare. Për këtë arsye, projekti nuk konsiderohet burim i ndotjes ndërkufitare të ajrit.

6.6. Cilësia e ujit

Në kuadër të projektit për zonën e eksploatimit të gurit gëlqeror nga “StoneX Holding” SH.P.K., cilësia e ujit nuk pritet të ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga procesi i punës,

pasi aktiviteti i planifikuar përfshin vetëm minimin e masës shkëmbore, ngarkimin e materialit në kamionë dhe transportin e tij, pa përdorim të ujit në proces teknologjik dhe pa gjenerim të ujërave teknologjike apo industriale. Duke qenë se në lokacion nuk zhvillohet thërrmim, larje apo përpunim tjetër i materialit, rreziku për ndotje të ujërave nga vetë procesi i operimit vlerësohet si i ulët. Ndikimet e mundshme mund të lidhen vetëm me raste aksidentale, si rrjedhje të karburanteve ose vajrave nga makineritë, të cilat mund të menaxhohen përmes masave parandaluese dhe kontrollit teknik të pajisjeve.

6.7. Ndikimi i ndotësve në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore

Bazuar në natyrën e projektit, nuk pritet ndikim i rëndësishëm në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, pasi aktiviteti nuk përfshin shkarkime të ujërave të ndotura, nuk përdor ujë për proces pune dhe nuk krijon ujëra të zeza teknologjike. Ndotësit potencialë që teorikisht mund të ndikojnë në ujë janë të lidhur vetëm me situata të paparashikuara, si rrjedhje të naftës, vajrave lubrifikues ose materialeve të tjera nga makineritë operative. Këto ndikime do të ishin lokale dhe të kufizuara, ndërsa mundësia për depërtim në ujëra nëntokësore mbetet e ulët nëse respektohen masat për mirëmbajtje teknike, parkim të kontrolluar të makinerive dhe reagim të menjëhershëm në rast aksidenti. Për këtë arsye, ndikimi i projektit në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore vlerësohet si i ulët dhe i menaxhueshëm.

6.8. Mundësinë e ndikimit në ndotjen ndërkufitare të ujërave

Aktiviteti zhvillohet brenda një zone të kufizuar minerare dhe nuk gjeneron rrjedha të ndotura që mund të përhapen përtej zonës së projektit apo të ndikojnë në sisteme më të gjera ujore. Për këtë arsye, projekti nuk konsiderohet burim i ndotjes ndërkufitare të ujërave.

6.9. Ndryshimet hidromorfologjike, sasia dhe cilësia me referencë të veçantë për shkarkimet e ujërave të zeza

Projekti nuk parashihet të shkarkojë ndryshime hidromorfologjike të trupave ujorë, pasi aktiviteti i eksploatimit zhvillohet në një zonë të kufizuar tokësore dhe nuk përfshin ndërhyrje në shtretër lumenjsh, përroje, kanale apo trupa të tjerë ujorë. Po ashtu, projekti nuk përfshin përdorim të ujit në proces, nuk gjeneron ujëra teknologjike dhe nuk parashikon shkarkime të ujërave të zeza industriale. Sa i përket ujërave të zeza sanitare, duke qenë se aktiviteti realizohet nga personel i angazhuar në baza ditore dhe nuk parashihet ndërtimi i kampeve apo rezidencave, ndikimi nga kjo kategori mbetet minimal dhe i menaxhueshëm përmes organizimit të përshtatshëm sanitar sipas kushteve të operimit. Për rrjedhojë, nuk priten ndryshime të rëndësishme në sasinë apo cilësinë e ujërave si rezultat i projektit.

6.10. Toka

Ndikimet e projektit në tokë lidhen kryesisht me natyrën e aktivitetit mineral sipërfaqësor, i cili përfshin zgjerimin e zonës së eksploatimit të gurit gëlqeror, heqjen e shtresës sipërfaqësore dhe zhvillimin e operacioneve të minimit, ngarkimit dhe transportit të materialit. Këto ndërhyrje shkaktojnë ndryshime të drejtpërdrejta në sipërfaqen e tokës dhe në konfiguracionin natyror të terrenit brenda parcelës së projektit. Megjithatë, ndikimi është i kufizuar në zonën e dedikuar për aktivitet mineral dhe parashihet të menaxhohet përmes organizimit të kontrolluar të punës dhe rehabilitimit progresiv pas përfundimit të eksploatimit.

6.11. Ndikimi fizik, ndryshimi në topografinë lokale, erozioni i tokës, rrëshqitjet e tokës, etj.

Gjate eksploatimit do të shkaktohet ndryshim fizik të sipërfaqes dhe të topografisë lokale, si rezultat i minimit të masës shkëmbore dhe formimit progresiv të zonave punuese. Ndryshimet në relief janë të pritshme dhe përbëjnë një karakteristikë tipike të aktiviteteve minerare sipërfaqësore. Gjithashtu, heqja e shtresës së humusit dhe ekspozimi i terrenit mund të rrisin ndjeshmërinë ndaj erozionit, sidomos gjatë reshjeve intensive. Rreziku për rrëshqitje të tokës vlerësohet i kufizuar, por kërkon respektim të parametrave teknikë për stabilitetin e skarpave dhe organizimin e duhur të fazave të minimit. Me zbatimin e masave teknike për stabilizimin e terrenit, menaxhimin e ujërave atmosferike dhe rehabilitimin progresiv, këto ndikime mbeten të kontrollueshme dhe të menaxhueshme.

6.12. Ndikimi i emetimeve të ndotësve në vendndodhjen e projektit të planifikuar dhe në tokën përreth dhe krahasimin me treguesit e përcaktuar me norma dhe standarde sipas legjislacionit përkatës

Ndikimet e mundshme në tokë nga emetimet ndotëse lidhen kryesisht me depozitimin e pluhurit të krijuar gjatë minimit, shpërthimeve të kontrolluara, ngarkimit dhe transportit të materialit, si dhe me mundësinë e rrjedhjeve aksidentale të karburanteve ose vajrave nga makineritë operative. Depozitimi i pluhurit mund të ndikojë në sipërfaqen e tokës brenda dhe pranë zonës së eksploatimit, por për shkak të karakterit lokal të aktivitetit dhe mungesës së procesit industrial në lokacion, ky ndikim pritet të mbetet i kufizuar. Ndikimi në tokën përreth do të jetë më i ulët me rritjen e distancës nga zonat e nxjerrjes së gurit gëlqeror. Në rast se makineritë mirëmbahen rregullisht dhe zbatohen masa parandaluese për shmangien e rrjedhjeve, ndikimi në cilësinë e tokës vlerësohet i ulët dhe brenda niveleve të menaxhueshme sipas kërkesave të legjislacionit mjedisor në fuqi.

6.13. Ndikimi në shfrytëzimin e tokës dhe burimeve natyrore

Projekti ndikon drejtpërdrejt në mënyrën e shfrytëzimit të tokës, pasi sipërfaqja e përfshirë në eksploatim do të përdoret për aktivitet minerar dhe jo për përdorime të tjera të mundshme. Megjithatë, zona ka karakter minerar dhe pyjor, me dominim të gurit gëlqeror dhe me mbulesë të kufizuar të tokës bujqësore. Burimi natyror që shfrytëzohet në kuadër të projektit është gurit gëlqeror, e cila përbën edhe qëllimin kryesor të aktivitetit. Ky shfrytëzim realizohet në përputhje me planin minerar dhe me rezervat e miratuara, ndërsa ndikimi në përdorimin e tokës mbetet i kufizuar brenda parcelës së përcaktuar për eksploatim.

6.14. Sasia dhe cilësia e tokës bujqësore të humbur

Bazuar në përshkrimin e lokacionit dhe të dhënat kadastrale për zonën ku planifikohet eksploatimi i gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në Bllacë, Komuna e Suharekës, sipërfaqja e projektit nuk karakterizohet kryesisht si tokë bujqësore me vlerë të lartë prodhuese. Në kuadër të ngastrave të projektit paraqiten toka me bonitet të ndryshëm, ku disa sipërfaqe janë të klasës së V dhe VII, ndërsa disa pjesë janë të evidentuara si tokë pyjore. Këto kategori tregojnë se toka ka aftësi të kufizuar prodhuese për bujqësi intensive. Gjatë punëve përgatitore dhe hapjes së fronteve të eksploatimit do të ketë humbje të përkohshme dhe të drejtpërdrejtë të shtresës sipërfaqësore të tokës në zonën ku zhvillohet aktiviteti minerar. Shtresa humusore, aty ku është e pranishme, do të largohet me kujdes, do të deponohet veçmas dhe do të ruhet për t’u përdorur më vonë gjatë rehabilitimit dhe rikultivimit të sipërfaqeve të shfrytëzuara.

6.15. Ndikimi në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike

Projekti për eksploatimin e gurit gëlqeror do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në karakteristikat gjeologjike dhe gjeomorfologjike të lokacionit, pasi aktiviteti përfshin minimin e gurit gëlqeror, largimin e materialit dhe krijimin e fronteve të eksploatimit. Ndikimi kryesor lidhet me ndryshimin e konfiguracionit të terrenit dhe krijimin e skarpave minerare. Ky ndikim është i kufizuar brenda zonës së projektit dhe do të menaxhohet përmes zbatimit të planit minerar, ruajtjes së stabilitetit të shpateve dhe rehabilitimit progresiv të sipërfaqeve të shfrytëzuara.

6.16. Popullsia lokale

Lokacioni i projektit ndodhet jashtë zonës së banimit. Shtëpitë më të afërta janë në distancë më të madhe se 1 km nga zona e eksploatimit, prandaj ndikimi i drejtpërdrejtë në popullsinë lokale vlerësohet i kufizuar. Ndikimet e mundshme mund të lidhen me pluhurin, zhurmën, vibrimet dhe qarkullimin e kamionëve, por këto do të jenë të menaxhueshme përmes masave mbrojtëse dhe respektimit të orarit të punës.

6.17. Ndryshimet në numrin dhe strukturën e popullsisë dhe ndikimet të lidhura me mjedisin, popullsinë, përqendrimi dhe migrimi

Projekti nuk pritet të shkaktojë ndryshime në numrin, strukturën apo përqendrimin e popullsisë në zonën përreth. Aktiviteti nuk kërkon zhvendosje të banorëve, nuk ndikon në migrim dhe nuk krijon presion të ri urbanistik. Punëtorët do të angazhohen në baza ditore dhe nuk parashihet ndërtim i kampeve apo vendbanimeve të përkohshme. Ndikimet në popullsi janë kryesisht të karakterit lokal dhe të përkohshëm gjatë fazës së operimit.

6.18. Ndikimet vizuale të vendbanimeve

Ndikimet vizuale nga projekti lidhen me hapjen e fronteve të eksploatimit, largimin e vegjetacionit dhe ndryshimin e pamjes natyrore të terrenit. Për shkak se zona ndodhet larg qendrave të banuara dhe në terren kryesisht kodrinor e pyjor, ndikimi vizual në vendbanimet përreth pritet të jetë i kufizuar. Rehabilitimi gradual i sipërfaqeve të shfrytëzuara do të ndihmojë në zvogëlimin e ndikimit vizual pas përfundimit të aktivitetit.

6.19. Ndikimet e emetimit të ndotësve, zhurmës, vibrimet, nxehtësisë dhe të gjitha llojet e rrezatimit në shëndetin e njeriut

Gjatë operimit mund të krijohen pluhur, gazra nga makineritë me naftë, zhurmë dhe vibrime nga minimi, ngarkimi dhe transporti. Nuk priten emetime të nxehtësisë apo rrezatim jonizues dhe jojonizues, pasi projekti nuk përfshin procese industriale apo pajisje që gjenerojnë rrezatim. Ndikimi më i ndjeshëm mund të jetë për punëtorët në lokacion, të cilët duhet të përdorin pajisje mbrojtëse personale. Për popullsinë përreth, ndikimi pritet të jetë i ulët për shkak të distancës mbi 1 km nga shtëpitë e banimit.

6.20. Ndikimet socio-ekonomike

Projekti pritet të ketë ndikim pozitiv socio-ekonomik, pasi mundëson shfrytëzimin e resurseve minerare, angazhimin e fuqisë punëtore dhe furnizimin e tregut me material gëlqeror. Aktiviteti mund të ndikojë pozitivisht në të hyrat e kompanisë, në punësim dhe në zhvillimin e sektorit të ndërtimit. Ndikimet negative socio-ekonomike janë të kufizuara dhe lidhen kryesisht me shqetësimet e mundshme nga trafiku, pluhuri dhe zhurma gjatë operimit.

6.21. Ndikimi i projektit në strukturën e ekonomisë lokale, sipas sektorit prodhues dhe degës kryesore të zonës

Eksploatimi i gurit gëlqeror ndërlidhet me sektorin minerar dhe ndërtimor, të cilët kanë rëndësi për ekonominë lokale dhe rajonale. Projekti kontribuon në sigurimin e materialit ndërtimor për tregun dhe ndihmon në zhvillimin e zinxhirit të furnizimit për sektorin e ndërtimit. Ndikimi në

sektorët tjerë, si bujqësia dhe shërbimet, pritet të jetë i kufizuar, pasi projekti zhvillohet në zonë jashtë qendrave të banuara dhe nuk prek drejtpërdrejt tokë bujqësore me vlerë të lartë prodhuese.

6.22. Numri i vendeve të punës të krijuara gjatë fazave të ndërtimit dhe funksionimit të projektit, si dhe humbjet e mundshme të vendeve të punës në sektorët apo zonat e prekura

Projekti nuk ka fazë ndërtimi të objekteve industriale, por përfshin punë përgatitore dhe fazë operimi. Gjatë funksionimit do të angazhohen punëtorë për shpim, minim, operim të makinerive, transport, mbikëqyrje teknike dhe siguri në punë. Nuk pritet humbje e vendeve të punës në sektorët tjerë, pasi aktiviteti nuk zhvendos biznese, nuk prek vendbanime dhe nuk ndërpret veprimtari ekzistuese të rëndësishme në zonë.

6.23. Kontributi i projektit në ekonominë rajonale dhe kombëtare

Projekti kontribuon në ekonominë rajonale dhe kombëtare përmes shfrytëzimit të resurseve minerare vendore, furnizimit me gur gëlqeror për nevojat e tregut, krijimit të vendeve të punës dhe pagesës së detyrimeve ligjore. Gjithashtu, projekti ndihmon në furnizimin e sektorit të ndërtimit me material bazë, duke ulur varësinë nga burime të tjera të furnizimit.

6.24. Ekosistemet dhe gjeologjia

Zona e projektit ka karakter kryesisht pyjor, kodrinor dhe mineral, me prani të masës shkëmbore të gurit gëlqeror. Ndikimi në gjeologji është i drejtpërdrejtë për shkak të minimimit dhe largimit të materialit shkëmbor. Ndikimi në ekosisteme lidhet me largimin e vegjetacionit në sipërfaqen e eksploatimit dhe shqetësimin e mundshëm të faunës lokale. Këto ndikime do të kufizohen brenda zonës së lejuar dhe do të zbuten përmes rehabilitimit progresiv.

6.25. Humbja dhe dëmtimi i specieve bimore dhe shtazore dhe habitateve të tyre

Gjatë përgatitjes së terrenit dhe hapjes së fronteve të eksploatimit mund të ketë humbje të vegjetacionit dhe shqetësim të habitateve lokale. Fauna e zonës mund të largohet përkohësisht për shkak të zhurmës, vibrimeve dhe lëvizjes së makinerive. Nuk janë identifikuar specie të mbrojtura apo habitate të veçanta brenda zonës së projektit. Ndikimi duhet të kufizohet duke mos dalë jashtë kufijve të lejuar të eksploatimit dhe duke realizuar rikultivimin e sipërfaqeve pas përfundimit të punimeve.

6.26. Humbja dhe dëmtimi i veçorive gjeologjike, paleontologjike dhe gjeomorfologjike, biodiversitetit, florës dhe faunës, pasurive natyrore të mbrojtura, specieve të rralla dhe të rrezikuara të bimëve dhe kafshëve të egra dhe habitateve të tyre

Në zonën e projektit nuk janë identifikuar pasuri natyrore të mbrojtura, zona paleontologjike apo specie të rralla dhe të rrezikuara të regjistruara. Ndikimi kryesor do të jetë në veçoritë gjeologjike dhe gjeomorfologjike të terrenit për shkak të minimumit të gurit gëlqeror dhe ndryshimit të relievit. Ndikimet në florë dhe faunë pritet të jenë lokale dhe të kufizuara brenda zonës së eksploatimit. Rehabilitimi i terrenit pas përfundimit të aktivitetit do të ndihmojë në rikthimin gradual të mbulesës bimore dhe stabilitetit të zonës.

6.27. Qëllimi dhe shfrytëzimi i sipërfaqeve

Sipërfaqja e projektit do të shfrytëzohet për eksploatimin sipërfaqësor të gurit gëlqeror. Përdorimi kryesor i zonës lidhet me aktivitetin mineral, përfshirë frontet e minimumit, rrugët e brendshme, hapësirat për ngarkim dhe qarkullimin e makinerive. Pas përfundimit të eksploatimit, sipërfaqja do të rehabilitohet dhe do të rikthehet në gjendje të qëndrueshme, sipas planit të mbylljes dhe rehabilitimit.

6.28. Sipërfaqet e ndërtuara dhe të pa ndërtuara

Projekti nuk parasheh ndërtim të objekteve industriale në zonën e eksploatimit. Sipërfaqja e projektit përbëhet kryesisht nga terren i pa ndërtuar, me karakter pyjor, kodrinor dhe shkëmbor. Ndërhyrjet do të lidhen me organizimin e rrugëve të brendshme, fronteve të minimumit dhe hapësirave për manovrim të makinerive.

6.29. Shfrytëzimi i tokës

Shfrytëzimi i tokës do të jetë 7.89 ha. Disa pjesë të sipërfaqes janë të klasës V dhe VII, ndërsa disa pjesë janë tokë pyjore. Ndikimi në tokën bujqësore me vlerë të lartë prodhuese vlerësohet i kufizuar. Pas përfundimit të eksploatimit, zona do të rehabilitohet përmes riformësimit të terrenit, stabilizimit të skarpave dhe rikultivimit me bimësi të përshtatshme.

6.30. Infrastruktura komunale

Projekti nuk pritet të shkaktojë ngarkesë të konsiderueshme në infrastrukturën komunale. Nuk kërkohet furnizim me ujë industrial, kanalizim apo energji elektrike për proces teknologjik në lokacion. Ndërlidhja kryesore me infrastrukturën komunale është përdorimi i rrugëve ekzistuese për qasje dhe transport. Mbeturinat komunale nga personeli do të menaxhohen përmes sistemit komunal apo operatorit të kontraktuar.

6.31. Trafiku

Ndikimi në trafik lidhet me lëvizjen e kamionëve që transportojnë gurin gëlqeror nga zona e eksplotimit drejt impiantit të planifikuar të thërrmimit dhe separimit. Rritja e qarkullimit të mjeteve të rënda mund të ndikojë në rrugët lokale, sidomos gjatë orarit të punës. Për këtë arsye duhet të respektohen shpejtësitë e lejuara, të mirëmbahen rrugët e brendshme dhe të organizohet transporti në mënyrë që të shmangen pengesat për banorët dhe trafikun lokal.

6.32. Furnizimi me ujë

Në kuadër të projektit nuk parashihet furnizim me ujë për proces pune.

6.33. Energjia

Projekti nuk kërkon furnizim me energji elektrike.

6.34. Ujërat e zeza

Projekti nuk gjeneron ujëra të zeza teknologjike apo industriale.

6.35. Gjenerimi i mbeturinave

Gjatë operimit të projektit nuk gjenerohen mbeturina industriale apo mbetje nga përpunimi, pasi në lokacion zhvillohet vetëm minimi dhe transporti i gurit gëlqeror. Mbeturinat kryesore që krijohen janë mbeturinat komunale të gjeneruara nga personeli gjatë qëndrimit në vendpunishte, si ambalazhe ushqimore, shishe plastike dhe mbetje të tjera të zakonshme. Sasia e tyre është e vogël dhe lidhet drejtpërdrejt me numrin e punëtorëve dhe kohëzgjatjen e operimit. Këto mbeturina do të grumbullohen në mënyrë të kontrolluar dhe do të largohen përmes sistemit komunal ose operatorit të kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave.

6.36. Pasuritë e mbrojtura natyrore, kulturore dhe rrethina e tyre, veçoritë e peizazhit

Në zonën ku planifikohet eksplotimi i gurit gëlqeror nuk janë identifikuar pasuri të mbrojtura natyrore, kulturore apo historike brenda ngastrave të projektit apo në afërsi të drejtpërdrejtë të tyre. Lokacioni ka karakter kryesisht pyjor, kodrinor dhe minerar. Ndikimi në peizazh lidhet me hapjen e fronteve të eksplotimit, largimin e vegjetacionit dhe ndryshimin e konfiguracionit të terrenit. Ky ndikim do të zvogëlohet përmes rehabilitimit progresiv dhe rikultivimit të sipërfaqeve pas përfundimit të shfrytëzimit.

6.37. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis përmban gjithashtu informacione që rezultojnë

Ndikimet e projektit në mjedis rezultojnë kryesisht nga punët përgatitore, minimi i kontrolluar i gurit gëlqeror, ngarkimi i materialit në kamionë, transportimi drejt impiantit të planifikuar të thërrmimit dhe separimit, përdorimi i makinerive me naftë dhe ndryshimi i përkohshëm i përdorimit të sipërfaqes së tokës. Këto ndikime kanë karakter lokal dhe janë të menaxhueshme përmes masave teknike, organizative dhe mjedisore.

6.38. Zbatimi i projektit, duke përfshirë punimet e largimit, sipas rastit

Gjatë zbatimit të projektit duhet të merren masa për kontrollin e pluhurit, zhurmës, vibrimeve, ujërave atmosferike dhe mbeturinave. Makineritë duhet të jenë të mirëmbajtura, ndërsa çdo rrjedhje e vajrave apo karburanteve duhet të trajtohet menjëherë, për të shmangur ndotjen e tokës dhe ujërave.

Punimet e largimit, nëse paraqiten të nevojshme, do të përfshijnë largimin e pajisjeve, materialeve të përkohshme, mbeturinave dhe pastrimin e lokacionit pas përfundimit të aktivitetit. Pas përfundimit të punimeve, zona duhet të rehabilitohet gradualisht, me qëllim kthimin e saj në gjendje të qëndrueshme dhe të pranueshme nga aspekti mjedisor dhe peizazhor.

6.39. Ndikimet kumulative të projekteve të tjera ekzistuese

Ndikimet kumulative mund të lidhen me aktivitetet minerare, transportin e materialeve dhe impiantin e planifikuar të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Duke qenë se materiali i nxjerrë do të transportohet drejt këtij impianti, ndikimet kumulative mund të paraqiten në formë të pluhurit, zhurmës, qarkullimit të kamionëve dhe ndryshimeve vizuale në zonë. Këto ndikime duhet të menaxhohen përmes organizimit të mirë të transportit, mirëmbajtjes së rrugëve dhe zbatimit të masave për kontrollin e pluhurit e zhurmës.

6.40. Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis

Shtrirja hapësinore e ndikimeve negative pritet të jetë kryesisht lokale dhe e kufizuar brenda zonës së eksploatimit dhe rrugëve të qarkullimit të kamionëve. Ndikimet në ajër, zhurmë dhe vibrime mund të shtrihen në afërsi të lokacionit, por për shkak se shtëpitë e banimit ndodhen më shumë se 1 km larg, ndikimi i drejtpërdrejtë në popullsi vlerësohet i kufizuar. Ndikimet në tokë dhe peizazh do të jenë të kufizuara brenda ngastrave të projektit.

6.41. Shkarkimi i ujërave të ndotura gjatë fazës së ndërtimit

Projekti nuk ka fazë ndërtimi të objekteve industriale dhe nuk parasheh gjenerim apo shkarkim të ujërave të ndotura gjatë punëve përgatitore. Punët në terren përfshijnë vetëm pastrimin, rregullimin e sipërfaqes dhe organizimin e qarkullimit të makinerive.

6.42. Emetimet e rrezatimit elektromagnetik gjatë ndërtimit

Gjatë zbatimit të projektit nuk priten emetime të rrezatimit elektromagnetik, pasi nuk do të instalohen pajisje apo sisteme që krijojnë rrezatim të tillë.

6.43. Emetimet në ajër të gazeve serrë gjatë operimit

Gjatë operimit do të ketë emetime të kufizuara të gazrave serrë nga përdorimi i karburantit dizel në makineri, pajisje shpimi, ekskavatorë, ngarkues dhe kamionë transportues. Këto emetime lidhen me djegien e karburantit dhe kanë karakter lokal. Projekti nuk përfshin procese industriale që gjenerojnë sasi të mëdha të gazrave serrë. Për zvogëlimin e emetimeve do të bëhet mirëmbajtja e rregullt e makinerive, përdorimi racional i karburantit dhe organizimi efikas i transportit.

6.44. Ndikimet në ndryshimet klimatike

Ndikimi i projektit në ndryshimet klimatike vlerësohet i kufizuar, pasi aktiviteti nuk përfshin prodhim industrial apo procese me emetime të larta. Emetimet kryesore lidhen me përdorimin e naftës nga makineritë dhe kamionët. Nga ana tjetër, projekti mund të jetë i ndjeshëm ndaj kushteve klimatike, si reshjet intensive, erozioni, rrjedhjet sipërfaqësore dhe periudhat e thata që rrisin pluhurin. Për këtë arsye duhet të zbatohen masa për menaxhimin e ujërave atmosferike, stabilizimin e terrenit, mirëmbajtjen e rrugëve të brendshme dhe kontrollin e pluhurit gjatë periudhave të thata.

7. PËRSHKRIMI I MASAVE PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR OSE ELIMINUAR NDIKIMIN NË MJEDIS

7.1.Masat e parashikuara me legjislacion

Masat për parandalimin, reduktimin ose eliminimin e ndikimeve në mjedis duhet të zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, vlerësimin e ndikimit në mjedis, mbrojtjen e ujërave, ajrit, tokës, menaxhimin e mbeturinave, mbrojtjen nga zhurma dhe sigurinë në punë.

Kompania është e obliguar që aktivitetin ta zhvillojë vetëm brenda kushteve të miratuara dhe të respektojë të gjitha kërkesat ligjore, teknike dhe mjedisore që dalin nga pëlqimi mjedisor, lejet përkatëse dhe aktet tjera të institucioneve kompetente.

Masat kryesore të parashikuara me legjislacion përfshijnë kontrollin e emetimeve në ajër, menaxhimin e ujërave atmosferike dhe të ndotura, mbrojtjen e tokës nga ndotja, menaxhimin e rregullt të mbeturinave, kufizimin e zhurmës dhe vibrimeve, mirëmbajtjen e pajisjeve, si dhe rehabilitimin e lokacionit pas përfundimit të aktivitetit.

Gjatë gjithë periudhës së operimit, operatori duhet të sigurojë monitorim të rregullt të ndikimeve mjedisore dhe të ndërmarrë masa korrigjuese në rast se evidentohen tejkalime apo ndikime të paparashikuara. Zbatimi i këtyre masave është i domosdoshëm për mbrojtjen e mjedisit, shëndetit të njerëzve dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore.

7.2.Masat që duhen marrë në rast aksidentesh dhe fatkeqësive të mëdha

Në rast aksidentesh apo fatkeqësish të mëdha, kompania duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për mbrojtjen e punëtorëve, popullsisë përreth, pronës dhe mjedisit. Çdo situatë emergjente duhet të trajtohet sipas planit të brendshëm për reagim emergjent, ku përcaktohen përgjegjësitë, mënyra e njoftimit dhe veprimet që duhet të ndërmerren.

Në rast zjarri, rrjedhjeje të karburanteve apo vajrave, dëmtimi të makinerive, rrëshqitjeje të dheut, aksidenti në punë apo ndonjë ngjarjeje tjetër të paparashikuar, aktiviteti duhet të ndërpritet menjëherë në zonën e rrezikut. Punëtorët duhet të largohen në vend të sigurt, ndërsa zona duhet të izohet për të parandaluar përhapjen e rrezikut.

Operatori duhet të sigurojë pajisje bazë për reagim emergjent, si fikës zjarri, kuti të ndihmës së parë, materiale absorbuese për rrjedhje të vajrave dhe karburanteve, pajisje mbrojtëse personale dhe mjete sinjalizuese. Pajisjet duhet të jenë të qasshme dhe në gjendje funksionale gjatë gjithë kohës së operimit.

Në rast të ndotjes aksidentale të tokës apo ujërave, materiali i ndotur duhet të izolohet, të grumbullohet dhe të largohet sipas rregullave për menaxhimin e mbeturinave. Nuk lejohet përhapja e ndotjes në sipërfaqe më të gjera, në kanale kulluese, rrjedha ujore apo toka përreth. Për çdo aksident serioz apo fatkeqësi të madhe duhet të njoftohen menjëherë institucionet kompetente, si shërbimi i zjarrfikësve, emergjenca mjekësore, policia dhe organet mjedisore. Pas përfundimit të rastit, duhet të bëhet evidentimi i ngjarjes, vlerësimi i dëmeve dhe përcaktimi i masave për parandalimin e përsëritjes së saj.

7.3. Planet dhe zgjidhjet teknike për mbrojtjen e mjedisit

Për mbrojtjen e mjedisit gjatë eksploatimit të gurit gëlqeror parashihen këto zgjidhje teknike dhe organizative:

- Punimet të zhvillohen vetëm brenda kufijve të lejuar të zonës së projektit;
- Të bëhet minimi i kontrolluar sipas planit minerar dhe kushteve të sigurisë teknike;
- Rrugët e brendshme të mirëmbahen rregullisht dhe të lagen gjatë periudhave të thata për zvogëlimin e pluhurit;
- Kamionët të qarkullojnë me shpejtësi të kufizuar brenda zonës së projektit;
- Makineritë dhe kamionët të mirëmbahen rregullisht për të zvogëluar emetimet e gazrave, zhurmën dhe rrezikun nga rrjedhjet e vajrave apo karburantit;
- Shtresa sipërfaqësore e tokës, aty ku është e pranishme, të largohet me kujdes dhe të ruhet për rehabilitim të mëvonshëm;
- Mbeturinat komunale nga personeli të grumbullohen në kontejnerë dhe të largohen nga operatori i kontraktuar;
- Të mos lejohet shkarkimi i pakontrolluar i ujërave, vajrave, karburanteve apo mbeturinave në tokë;
- Pas përfundimit të eksploatimit të bëhet rehabilitimi progresiv i sipërfaqes, stabilizimi i skarpave dhe rikultivimi me bimësi të përshtatshme.

7.4. Masat të tjera që mund të ndikojnë në parandalimin, zvogëlimin ose neutralizimin e efekteve të dëmshme në mjedis

Përveç masave teknike dhe ligjore, gjatë operimit të projektit duhet të zbatohen edhe masa shtesë për mbrojtjen e mjedisit:

- Të kufizohet lëvizja e makinerive vetëm në rrugët dhe hapësirat e përcaktuara;
- Të shmanget dëmtimi i panevojshëm i vegjetacionit përreth zonës së eksploatimit;
- Të respektohet orari i punës për të kufizuar ndikimet nga zhurma dhe vibrimet;

-
- Të përdoren pajisje mbrojtëse personale nga punëtorët, sidomos gjatë miniminit, shpimit, ngarkimit dhe transportit;
 - Të vendosen shenja paralajmëruese dhe informuese në zonën e punës;
 - Të bëhet kontroll i rregullt i gjendjes së skarpave dhe stabilitetit të terrenit;
 - Të bëhet monitorim periodik i ndikimeve kryesore, sidomos pluhurit, zhurmës dhe gjendjes së tokës;
 - Të mbahet lokacioni i pastër dhe i organizuar gjatë gjithë periudhës së operimit;
 - Të realizohet rehabilitimi gradual i pjesëve të shfrytëzuara, pa pritur përfundimin e plotë të aktivitetit.

Zbatimi i këtyre masave siguron që ndikimet e projektit në ajër, tokë, ujë, biodiversitet, peizazh dhe popullsi të jenë të kufizuara, të kontrolluara dhe të menaxhueshme gjatë gjithë periudhës së funksionimit të projektit.

8. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

8.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis

Programi i monitorimit për projektin e eksploatimit të gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, ka për qëllim përcjelljen e ndikimeve të mundshme në mjedis gjatë fazës së operimit. Monitorimi do të fokusohet kryesisht në pluhur, zhurmë, vibrime, gjendjen e tokës, stabilitetin e terrenit dhe ndikimet e mundshme nga qarkullimi i makinerive dhe kamionëve.

8.2. Prezantimin e gjendjes mjedisore përpara se projekti të vihet në punë ose fillimi i aktiviteteve në vendet ku ndikimi mjedisor pritet

Para fillimit të aktivitetit duhet të evidentohen kushtet ekzistuese të lokacionit, duke përfshirë gjendjen e tokës, mbulesën bimore, qasjen rrugore, afërsinë me vendbanimet dhe burimet ujore. Zona e projektit ndodhet në terren kryesisht pyjor dhe minerar, jashtë zonës së drejtpërdrejtë të banimit. Shtëpitë e banimit ndodhen në distancë më të madhe se 1 km, ndërsa Lumi Mirushë ndodhet rreth 1.24 km larg nga zona e projektit.

8.3. Parametrat në bazë të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis

Për aktivitetin e eksploatimit të gurit gëlqeror nga “StoneX Holding” SH.P.K., parametrat kryesorë që do të monitorohen për të përcaktuar efektet e mundshme të dëmshme në mjedis lidhen me cilësinë e ajrit, nivelet e zhurmës dhe vibrimeve, dhe gjendjen e tokës. Do të vlerësohet niveli i pluhurit gjatë minimit, ngarkimit dhe transportit të materialit, si dhe emetimet nga makineritë dhe kamionët me motor dizel. Po ashtu do të monitorohen nivelet e zhurmës dhe vibrimeve gjatë shpërthimeve të kontrolluara dhe funksionimit të pajisjeve minerare. Gjendja e tokës do të kontrollohet për stabilitetin e terrenit dhe për çdo rrjedhje të mundshme të karburantit apo vajrave, ndërsa do të mbikëqyret edhe menaxhimi i mbeturinave komunale nga personeli dhe organizimi i rrjedhjeve sipërfaqësore nga reshjet. Monitorimi i vazhdueshëm i këtyre parametrave mundëson identifikimin në kohë të çdo devijimi nga kushtet e lejuara dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese, në mënyrë që ndikimet mjedisore të mbeten të kontrolluara dhe brenda standardeve ligjore.

8.4. Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar

Matjet dhe kontrollimet do të realizohen brenda zonës së eksploatimit, kryesisht në frontet e punës, në rrugët e brendshme të qarkullimit dhe në pikat ku realizohen shpërthimet dhe ngarkimi i materialit. Sipas nevojës, kontrollime mund të kryhen edhe në kufijtë e parcelës minerare për të vlerësuar përhapjen e pluhurit dhe zhurmës. Gjatë periudhave me aktivitet më intensiv, si në fazat me shpërthime më të shpeshta, monitorimi do të jetë më i rregullt. Në

operim normal, kontrollet do të kryhen në mënyrë periodike, përmes inspektimeve të brendshme dhe vlerësimeve teknike. Matjet e zhurmës, pluhurit apo vibrimeve, kur kërkohet nga autoritetet kompetente ose sipas kushteve të lejes mjedisore, do të realizohen me pajisje të përshtatshme dhe nga persona apo institucione të autorizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8.5.Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera

Raportet e monitorimit për projektin e zonës së eksploatimit të gurit gëlqeror do të përfshijnë rezultatet e matjeve dhe kontroleve të kryera për pluhur, nivelet e zhurmës dhe vibrimeve, gjendjen e terrenit, si dhe menaxhimin e mbeturinave komunale dhe kontrollin e mundshëm të rrjedhjeve të karburantit apo vajrave. Në raport do të përfshihet analiza e të dhënave dhe krahasimi me vlerat kufitare të lejuara sipas legjislacionit në fuqi. Në rast se evidentohen devijime nga standardet e lejuara, raporti do të përmbajë edhe masa korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e gjendjes. Dorëzimi i raporteve do të bëhet në mënyrë periodike, sipas kërkesave të autoriteteve kompetente dhe kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore dhe minerare, duke siguruar transparencë dhe përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.

8.6.Detyrimin për infomuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera

Kompania “StoneX Holding” SH.P.K. është e obliguar të sigurojë transparencë dhe të informojë publikun lidhur me rezultatet e monitorimit mjedisor për aktivitetin e zgjerimit të zonës së eksploatimit të gurit gëlqeror, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e lejes mjedisore dhe minerare. Informimi realizohet përmes raporteve zyrtare që i dorëzohen autoriteteve kompetente, ndërsa në rast se kërkohet, rezultatet mund të bëhen publike përmes njoftimeve apo formave të tjera të komunikimit të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse. Kjo siguron që aktiviteti të zhvillohet me përgjegjësi dhe në përputhje me parimet e transparencës dhe mbrojtjes së mjedisit.

8.7.Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis

Zona e projektit për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, ndodhet brenda territorit të Republikës së Kosovës dhe nuk gjendet në afërsi të drejtpërdrejtë me kufirin shtetëror. Bazuar në natyrën e aktivitetit, i cili përfshin vetëm minimin e gurit gëlqeror, ngarkimin e materialit në kamionë dhe transportimin e tij drejt impiantit të planifikuar të thërrmimit dhe separimit të kompanisë, nuk parashikohen ndikime të drejtpërdrejta dhe të matshme që mund të shtrihen përtej kufirit shtetëror. Ndikimet e projektit kanë karakter lokal dhe lidhen kryesisht me pluhurin, zhurmën, vibrimet dhe ndryshimin e relievit brenda zonës së eksploatimit.

9. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

9.1. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit ka për qëllim parandalimin, zvogëlimin dhe kontrollimin e ndikimeve të mundshme në mjedis. Masat mjedisore duhet të zbatohen nga faza përgatitore, gjatë operimit të projektit dhe deri në përfundimin e aktivitetit dhe rehabilitimin e lokacionit.

Gjatë fazës përgatitore duhet të bëhet organizimi i zonës së punës, përcaktimi i kufijve të aktivitetit dhe shmangia e ndërhyrjeve të panevojshme jashtë sipërfaqes së lejuar. Duhet të sigurohet që makineritë dhe pajisjet të jenë në gjendje të mirë teknike, ndërsa punëtorët të jenë të informuar për masat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Gjatë fazës së operimit duhet të zbatohen masa për kontrollin e pluhurit, zhurmës, vibrimeve, mbeturinave dhe ujërave atmosferike. Rrugët dhe sipërfaqet ku krijohet pluhur duhet të spërkatën sipas nevojës, makineritë duhet të mirëmbahen rregullisht, ndërsa vajrat, karburantet dhe materialet tjera ndotëse duhet të menaxhohen me kujdes për të shmangur ndotjen e tokës dhe ujërave.

Mbeturinat që krijohen gjatë aktivitetit duhet të grumbullohen në vende të caktuara, të ndahen sipas llojit dhe të largohen nga operatorë të autorizuar. Nuk lejohet hedhja apo deponimi i pakontrolluar i mbeturinave brenda ose jashtë lokacionit të projektit.

Pas përfundimit të aktivitetit, lokacioni duhet të pastrohet dhe të rehabilitohet gradualisht. Rehabilitimi duhet të përfshijë stabilizimin e terrenit, rregullimin e sipërfaqeve të dëmtuara dhe rikthimin e vegjetacionit aty ku është e mundur. Këto masa sigurojnë që ndikimet në tokë, peizazh dhe mjedisin përreth të zvogëlohen sa më shumë.

Zbatimi i vazhdueshëm i këtyre masave mundëson menaxhim të qëndrueshëm të projektit dhe mbrojtje efektive të mjedisit gjatë gjithë ciklit të tij.

9.2. Pajtushmeria me pëlqim mjedisor

Zbatimi dhe operimi i projektit për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K. do të realizohet në përputhje të plotë me kushtet e përcaktuara në pëlqimin mjedisor, lejen nga KPMM dhe legjislacionin mjedisor në fuqi. Kompania është përgjegjëse për zbatimin e të gjitha masave mbrojtëse të përcaktuara në raport, për monitorimin e rregullt të ndikimeve në ajër, zhurmë, vibrime, tokë dhe për menaxhimin e mbeturinave komunale. Po ashtu, kompania do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen teknike të makinerive dhe për parandalimin e çdo ndotjeje të mundshme nga karburantet apo vajrat. Kompania do të bashkëpunojë me autoritetet kompetente, organet inspektuese dhe institucionet përgjegjëse për

mbrojtjen e mjedisit. Çdo ndryshim eventual në kapacitetin e nxjerrjes, mënyrën e operimit, shtrirjen e zonës së eksploatimit apo parametrat teknikë të projektit do të trajtohet në përputhje me procedurat ligjore dhe do të njoftohen autoritetet kompetente para zbatimit të tyre.

9.3. Inkurajimi i zhvillimit të sistemit të menaxhimit mjedisor në përputhje me standardin ISO 14000

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës mjedisore, kompania synon zhvillimin dhe forcimin e sistemit të menaxhimit mjedisor, në përputhje me parimet e standardit ISO 14000. Zbatimi i këtij sistemi do të kontribuojë në:

- identifikimin dhe kontrollin sistematik të ndikimeve mjedisore;
- përmirësimin e efikasitetit operativ;
- rritjen e përgjegjësisë mjedisore të personelit;
- përmbushjen më të lartë të kërkesave ligjore dhe institucionale.

Zhvillimi i sistemit të menaxhimit mjedisor do të realizohet në mënyrë graduale, duke u përshtatur me natyrën dhe shkallën e aktivitetit të projektit.

10. INFORMACIONE SHITESË DHE KARAKTERISTIKAT E PROJEKTIT

10.1. Informacionet dhe karakteristikat shitesë të projektit për përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së raportit të VNM -së,

Projekti për eksploatimin e gurit gëlqeror është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe aktet nënligjore përkatëse, me qëllim sigurimin e një vlerësimi të plotë dhe realist të ndikimeve të mundshme në mjedis. Karakteristikat kryesore që kanë ndikuar në përcaktimin e qëllimit dhe përmbajtjes së këtij raporti janë natyra e aktivitetit minerar sipërfaqësor, procesi i punës që përfshin minimin e gurit gëlqeror, ngarkimin e materialit në kamionë dhe transportimin e tij drejt impiantit të planifikuar të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Në zonën e eksploatimit nuk parashihet përpunim industrial, thërrmim apo separim i materialit. Projekti nuk përfshin përdorim të ujit për proces teknologjik, nuk ka djegie industriale dhe nuk gjeneron ujëra teknologjike. Ndikimet kryesore mjedisore janë të karakterit lokal dhe lidhen me pluhurin, zhurmën, vibrimet, ndryshimin e relievit, largimin e shtresës sipërfaqësore të tokës dhe qarkullimin e mjeteve transportuese. Informacionet e përfshira në këtë raport synojnë të sigurojnë qartësi, përputhshmëri me kërkesat ligjore dhe bazë të mjaftueshme për përcaktimin e masave mbrojtëse. Qëllimi kryesor është që aktiviteti i eksploatimit të gurit gëlqeror të zhvillohet në mënyrë të kontrolluar, të sigurt dhe të qëndrueshme nga aspekti mjedisor.

10.2. Baza ligjore dhe rregullative

Hartimi i këtij Raporti të VNM-së është mbështetur në kornizën ligjore të Republikës së Kosovës, e cila është e harmonizuar me direktivat e Bashkimit Evropian për industrinë nxjerrëse dhe mbrojtjen e mjedisit.

Ligjet dhe Udhëzimet Administrative

- Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis: Ligji bazë që rregullon procedurat
- Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit: Përcakton parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Ligji Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet (i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158): Rregullon shfrytëzimin e resurseve minerale.
- Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës: Për mbrojtjen e pellgjeve ujore.
- Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja: Për limitet e pluhurit dhe gazeve.

- Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina: Për menaxhimin e mbeturinave (Ndryshohet/Plotësohet nga Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina).
- Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma: Për limitet akustike në zona të banuara.
- Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës: Për ruajtjen e biodiversitetit

Udhëzimet Administrative (UA):

- UA Nr. 07/2021: Për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër.
- UA Nr. 02/2022: Për normat e shkarkimit të ujërave të ndotura.
- UA Nr. 08/2009: Për vlerat kufitare të zhurmës.
- UA Nr. 04/2025: Për përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit

10.3. Dokumentacioni teknik i projektit

Përshkrimi i proceseve teknologjike dhe vlerësimi i ndikimit në këtë raport bazohet në dokumentacionin e detajuar inxhinierik të siguar nga investitori "Stonex Holding" SH.P.K. Dokumentet kryesore të shfrytëzuara përfshijnë: Projektin Kryesor Minerar (Xehetar), i cili përcakton parametrat gjeometrikë të mihjes dhe skemat e minimit; Elaboratin Gjeologjik, që vërteton rezervat dhe cilësinë e gëlqerorit; dhe Planin e Rehabilitimit të Sipërfaqeve.

Gjithashtu, janë konsultuar specifikimet teknike të garniturave shpuese (për sistemet e filtrimit) dhe hartat kadastrale që përcaktojnë kufijtë e parcelës prej 7.89 hektarësh. Ky material Teknik siguron që të gjitha vlerësimet mjedisore të jenë të sakta, të verifikueshme dhe të bazuara në të dhëna reale inxhinierike të aplikueshme për lokacionin e Seçishtës.

10.4. Të dhënat mjedisore dhe shkencore

Vlerësimi i gjendjes fillestare të mjedisit në Bllacë të Suharekës mbështetet në një bazë të gjerë të dhënash mjedisore dhe studimesh shkencore. Burimet parësore përfshijnë të dhënat klimatike dhe hidrologjike nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK), të cilat ndihmuan në modelimin e shpërndarjes së pluhurit dhe menaxhimin e ujërave. Karakterizimi i florës, faunës dhe peizazhit u realizua përmes vëzhgimeve direkte në terren dhe konsultimit me Planet Zhvillimore të Komunës së Suharekës.

Për aspektet gjeologjike dhe sizmike, janë shfrytëzuar rezultatet e kërkimeve laboratorike mbi vetitë e masivit gëlqeror dhe rezistencën e tij për industrinë nxjerrëse, duke siguruar që parashikimet e ndikimit mjedisor të kenë saktësi të lartë shkencore dhe integritet profesional.

11. BURIMET E TË DHËNAVE DHE LITERATURA

11.1. Lista e referimit të burimeve e të dhënave të përdorura për përshkrimet dhe vlerësimet e dhëna në raportin e VNM-së

Për hartimin e këtij Raporti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, janë shfrytëzuar dhe konsultuar këto burime: Plani Zhvillimor Komunal 2021-2029 .

TE DHËNAT NGA INVESTITORI

- suhareke.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/11/PZHK_Suhareka_-2021-2029-Pjesa-Tekstuale.pdf
- [Kosovo Geoportal](#)
- [Suhareke, 23000 to 42.4084343, 20.8303738 - Google Maps](#)
- [LIGJI NR. 08/L-181 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS](#)
- [UDHËZIM ADMINISTRATIV \(MMPHI\) NR.04/2025 PËR PËMBAJTJEN, METODOLOGJINË DHE PËRPUTHSHMËRINË E RAPORTIT ME KËRKESAT LIGJORE, PRAKTIKAT E ZBATUESHME DHE ASPEKTET E TJERA TEKNIKE TË RAPORTIT](#)
- [UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 13/2013 PËR KATALOGUN SHITETËROR TË MBETURINAVE](#)

12. SHTOJCA

1. Raporti i VNM-së i nënshkruar nga aplikuesi dhe personi fizik apo juridik i pajisur me licencë nga Ministria për hartimin e raporteve të VNM-së, me një (1) kopje në formë të shkruar dhe një (1) kopje në formë elektronike.
2. Dëshmia e pagesës për aplikim për pëlqim mjedisor.
3. Vlera investive e projektit në formë tabelare.
4. Certifikata e regjistrimit të biznesit.
5. Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme.
6. Kopja e planit me koordinata në sistemin Kosova Ref.
7. Plan i rilevimit të terrenit nga gjeodeti i licencuar, si dhe kopja e licencës së gjeodetit.
8. Kontrata e noterizuar për shfrytëzimin e ngastrës ose objektit, në rastet kur ngastra ose objekti nuk është pronë e aplikuesit.
9. Pëlqimi i Komunës për ushtrimin e veprimtarisë ose njoftim/informimi sipas Planit Zhvillimor Komunal, Hartës Zonale dhe kushteve ndërtimore.
10. Licenca valide e personit fizik ose juridik, e lëshuar nga Ministria.

13. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE E INFORMACIONIT

13.1. Hyrje

Projekti i propozuar ka të bëjë me eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K., në lokalitetin Bllacë, Komuna e Suharekës, në ngastrat kadastrale me nr. 04427-0, 04428-0, 04429-0, 04430-0, 04431-0, 04441-0 dhe 04442-0, Zona Kadastrale Bllacë, Komuna e Suharekës. Qëllimi i raportit është identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme në mjedis që mund të shkaktohen gjatë zhvillimit të aktivitetit minerar, si dhe përcaktimi i masave për parandalimin, zvogëlimin dhe menaxhimin e këtyre ndikimeve. Projekti i nënshtrohet procedurës së VNM-së sipas Ligjit Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

13.2. Përshkrimi i projektit

Projekti ka të bëjë me eksploatimin sipërfaqësor të gurit gëlqeror në zonën minerare të Bllacës. Aktiviteti përfshin punët përgatitore në terren, minimin e kontrolluar të masës shkëmbore, fragmentimin e gurit gëlqeror, ngarkimin me makineri dhe transportimin e materialit drejt impiantit të thërrmimit dhe separimit të kompanisë. Në lokacionin e eksploatimit nuk parashihet përpunim industrial i materialit, thërrmim apo separim. Këto procese do të realizohen në impiantin e kompanisë. Në zonën e projektit do të zhvillohen vetëm aktivitetet që lidhen me nxjerrjen, ngarkimin dhe transportimin e gurit gëlqeror. Operimi do të kryhet me pajisje për shpim dhe minim, ekskavatorë, ngarkues dhe kamionë transportues

13.3. Ndikimet kryesore mjedisore dhe masat mbrojtëse

Gjatë zhvillimit të projektit mund të paraqiten ndikime të përkohshme në mjedis, kryesisht si rezultat i minimit, përdorimit të makinerive, ngarkimit dhe transportimit të materialit. Ndikimet kryesore lidhen me krijimin e pluhurit, zhurmës, vibrimeve, ndryshimin e konfiguracionit të terrenit, ndikimet në tokë dhe peizazh, si dhe krijimin e mbeturinave komunale nga personeli. Ndikimi në ajër pritet të jetë kryesisht nga pluhuri që krijohet gjatë minimit, ngarkimit dhe qarkullimit të kamionëve. Për zvogëlimin e këtij ndikimi duhet të bëhet spërkatja e rrugëve dhe sipërfaqeve ku krijohet pluhur, sidomos gjatë periudhave të thata. Makineritë duhet të mirëmbahen rregullisht për të zvogëluar emetimet nga karburantet.

Ndikimi në tokë lidhet me ndërhyrjet fizike në terren, hapjen e fronteve të punës dhe ndryshimin gradual të relievit. Për këtë arsye, punimet duhet të zhvillohen vetëm brenda kufijve të lejuar të projektit. Shtresa sipërfaqësore e tokës, aty ku është e pranishme, duhet të ruhet dhe të përdoret për rehabilitimin e mëvonshëm të zonës.

Sa i përket ujërave, projekti nuk parasheh përdorim të ujit për proces teknologjik dhe nuk krijon ujëra industriale. Megjithatë, duhet të parandalohet ndotja aksidentale nga vajrat, karburantet apo materialet tjera ndotëse. Ujërat atmosferike duhet të menaxhohen në mënyrë që të mos bartin sedimente jashtë zonës së projektit.

Zhurma dhe vibrimet mund të paraqiten gjatë minimit, ngarkimit dhe transportimit të materialit. Këto ndikime duhet të kontrollohen përmes minimeve të planifikuara, mirëmbajtjes së pajisjeve, respektimit të orarit të punës dhe përdorimit të pajisjeve mbrojtëse nga punëtorët. Për shkak se lokacioni është mbi 1 km larg shtëpive të banimit, ndikimi në popullsinë përreth pritet të jetë i ulët

Mbeturinat që krijohen gjatë aktivitetit janë kryesisht mbeturina komunale nga personeli. Ato duhet të grumbullohen në vende të caktuara, të ndahen sipas llojit dhe të largohen nga operatorë të autorizuar. Pas përfundimit të aktivitetit, lokacioni duhet të pastrohet dhe të rehabilitohet gradualisht, duke përfshirë stabilizimin e terrenit, rregullimin e sipërfaqeve të dëmtuara dhe rikthimin e vegjetacionit aty ku është e mundur.

13.4. Përfitimet socio-ekonomike

Projekti pritet të ketë ndikim pozitiv socio-ekonomik, pasi mundëson shfrytëzimin e resurseve minerare, furnizimin e tregut me material gëlqeror dhe mbështetjen e sektorit të ndërtimit. Aktiviteti ndërlidhet drejtpërdrejt me sektorin minerar dhe ndërtimor, të cilët kanë rëndësi për ekonominë lokale dhe rajonale.

Përfitimet kryesore lidhen me angazhimin e fuqisë punëtore, krijimin e të hyrave për kompaninë, rritjen e aktivitetit ekonomik dhe sigurimin e materialit ndërtimor për tregun. Ndikimet negative socio-ekonomike vlerësohen të kufizuara dhe lidhen kryesisht me shqetësimet e mundshme nga trafiku, pluhuri dhe zhurma gjatë operimit.

13.5. Përfundim

Në bazë të vlerësimit të bërë, projekti për eksploatimin e gurit gëlqeror nga kompania “StoneX Holding” SH.P.K. në Bllacë të Komunës së Suharekës mund të realizohet pa shkaktuar ndikime të papranueshme në mjedis, me kusht që të zbatohen të gjitha masat mbrojtëse të parapara në raport. Ndikimet kryesore, si pluhuri, zhurma, vibrimet, ndikimi në tokë dhe ndryshimi i peizazhit, janë të menaxhueshme përmes organizimit të mirë të punës, mirëmbajtjes së makinerive, kufizimit të aktivitetit brenda zonës së lejuar, menaxhimit të mbeturinave dhe rehabilitimit gradual të lokacionit. Prandaj, projekti vlerësohet i pranueshëm nga aspekti mjedisor, teknik dhe socio-ekonomik, nëse zhvillohet në përputhje me kushtet ligjore, pëlqimin mjedisor, lejen nga KPMM dhe masat e përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit.